



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 4 (827911)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 31 janar 2025



Ministri Vengu: Riaktivizim i industrisë
ushtarake, rritje të kapitalit njerëzor dhe luftarak
Të barabartë përkrah **NATO-s**

Ministri Vengu inspektion punimet në Bazën Ajrore Farkë

Hangari i ri i skuadronit të helikopterëve ‘Black Hawk’, i cili po ndërtohet në Bazën Ajrore Farkë, u inspektua nga ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, i cili mes të tjerash tha: “Ky është një investim domethënës për nevojat e mjeteve të reja dhe ekuipazheve të tyre për realizimin e detyrave dhe misionit.


Me përfundimin e ndërtimit të këtij hangari, synohet kryerja e punimeve të mirëmbajtjes së helikopterëve 'Black Hawk' në këto mjedise nga vetë teknikët tanë, çka ul ndjeshëm kostot e mirëmbajtjes dhe rrit po ashtu ndjeshëm nivelin e gatishmërisë dhe operacionalitetit.

Nga ana tjetër, ekuipazhet e helikopterëve të rinj po trajnohen nga aleati ynë strategjik që të kryejnë jo vetëm transport trupash apo evakuime mjekësore, por të angazhohen edhe në emergjencat civile dhe operacionet e kërkim-shpëtimit.

Gjithashtu, trajnimi synon që nga gatishmëria ‘nga lindja e diellit deri në perëndim të tij’, të kalojë në gatishmëri 24 orë, për të realizuar operacione edhe natën”.



*Ekuipazhet e
helikopterëve të rinj po
trajtohen nga aleati ynë
strategjik që të kryejnë jo
vetëm transport trupash
apo evakuime mjekësore,
por të angazhohen edhe
në emergjencat civile dhe
operacionet e kërkim-
shpëtimit.*



U zhvillua në ambientet e Qendrës Stërvitore, ceremonia e certifikimit të kursantëve që përfunduan kursin EOD (Eliminimi i Pajisjeve Eksplozive) – niveli i parë.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla, si dhe komandantë të nënrepartëve vartëse dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij, gjeneral brigade Aleksandër Pando falënderoi instruktorët dhe stafin e Qendrës Stërvitore për profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre. Ai inkurajoi kursantët që të zbatojnë me përkushtim njohuritë e fituara dhe të përfaqësojnë denjësisht strukturat ushtarake në operacionet EOD.

Kursi EOD, i krijuar dhe zhvilluar me mbështetjen e Gardës së New Jersey-it që nga viti 2015, ka luajtur një rol të rëndësishëm në përgatitjen profesionale të personelit të Komandës Mbështetëse dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura.

Efektivë të strukturave të **Forcave të Armatosura** përfundojnë kursin EOD niveli i parë



Në këtë trajnim, kursantët përvetësuan njohuri bazë mbi identifikimin e municioneve xheniere, përdorimin e pajisjeve dhe aparaturave teknike EOD, si dhe zbatimin e procedurave teknike për eliminimin e rrezikut nga pajisjet eksplozive.



Kursantët zhvilluan gjithashtu ushtrime praktike me përdorimin e zjarr-përcjellësve dhe qarkut elektrik.

Me aftësitë e fituara, këta kursantë jo vetëm që mund të ndjekin kurse më të avancuara,

por edhe të kontribuojnë në operacione për pastrimin e zonave nga municionet e paplasura, si dhe të shërbejnë në të ardhmen si instruktorë EOD, duke dhënë një kontribut të vyer në strukturat ushtarake.

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu së bashku me kryetaren e Bashkisë së Durrësit Emiriana Sako, po monitorojnë nga afër situatën e reshjeve të shiut në qytetin e Durrësit, ku për shkak të intensitetit të madh uji ka depërtuar dhe në oborret e disa shtëpive në zonën e njohur si “Ura e Dajlanit” dhe Ish-Këneta.

Një ekskavator i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit ka mbërritur në Kanalin e Ujërave të Larta për ndërhyrje dhe pastrimin e kanaleve.

Ka rritje të nivelit të ujit në rrugë, duke shkaktuar vështirësi në qarkullimin e mjeteve dhe lëvizjen e këmbësorëve si dhe prani të ujit në disa zona të qytetit si dhe në Shkozët, ish-magazinat e Agro-transportit, Zona e Plazhit, Ish-Këneta, Stadiumi dhe lagjja “17 Nëntori”.

Niveli i ujit në Kanalin e Ujërave të Larta në unazën e qytetit ka arritur në një nivel kritik. Po ashtu, ka prani të ujit edhe në sipërfaqe bujqësore në njësinë administrative Sukth. Sipas informacionit të dhënë nga Ministria e Mbrojtjes, është bërë evakuimi i disa familjeve, të cilat janë akomoduar te Konvaleshenca, ndërsa gjatë natës forcat e

Ministri Vengu: Vigjilencë maksimale për të garantuar ndihmë dhe siguri



ushtrisë punuan për largimin e ujit nga burgu i Durrësit. Probleme të theksuara kanë rrugët dytësore në zonën e Durrësit të Ri, Shkozëtit, Gjykata e Apelit, pjesërisht Zona e Plazhit, ndërsa rreth 40 ha tokë është nën ujë.

Ndërkohë vazhdon puna nga forcat në terren



për largimin e ujit nga zonat e prekura nga reshjet intensive të shiut, në një pjesë të bashkisë së Durrësit. Në terren janë të angazhuara forca edhe nga MZSH, Autoriteti Portual, Bordi i Kullimit, ndërmarrjet e punëve publike të bashkisë. Përgjatë 24 orëve vazhdon puna nga

forcat në terren për largimin e ujit nga zonat e prekura.

Hidrovorët në Hamallaj dhe Porto Romano vijnë punën me kapacitet të plotë.

Në mbështetje të forcave në terren janë angazhuar 2 pompa thithëse me kapacitet të lartë dhe 3 kamionë të kalueshmërisë së lartë nga Forcat e Armatosura.

Gjatë natës, kapacitetet nga FA u përforcuan edhe me 2 pompa të vogla nga batalioni i mbështetjes Poshnjë, të cilat janë duke punuar për largimin e ujit te IEPV Durrës.

Grupet e punës janë në terren për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e saktë të dëmeve. “Strukturat vendore janë angazhuar për të riparuar pasojat e krijuara dhe po punojnë intensivisht për të menaxhuar situatën. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile do të vijojë të ndjekë situatën, për të koordinuar forcat deri në normalizimin e situatës. Vigjilencë maksimale në vijim për të garantuar ndihmë dhe siguri”, - tha ministri Vengu.

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu në këtë fillim viti të ri prezantoi për publikun disa prej objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes. Një prej tyre ishte dhe premtimi i qeverisë shqiptare për rritjen e pagave të efektivave ushtarakë dhe personelit civil, e cila në muajin janar filloi zbatimin.

“Më shumë të ardhura dhe më shumë dinjitet, ushtarakët meritojnë edhe më shumë, do të forcojmë kapacitetet e burimeve njerëzore dhe logjistike. Gjithashtu do të ketë rritje të kapaciteteve të mbrojtjes civile, përkrah asaj ushtarake. Duam të pozicionojmë Shqipërinë në mesataren e vendeve të NATO-s”, - u shpreh ministri Vengu.

Më tej ministri Vengu do të theksonte se: “Strategjia prioritarë e Ministrisë së Mbrojtjes është rritja e gatishmërisë. Po investojmë në blerjen e avionëve të dedikuar për mbrojtjen civile, kjo do të shërbejë për të stërvitur pilotë avionësh, jo vetëm ushtarakë. Do të gjenerojmë të ardhura nëpërmjet industrisë ushtarake. E gjithë paketa ligjore tashmë është miratuar, madje dhe aktet nënligjore. Dhe për këtë janë themeluar dy ente. Kompania jo shtetërore ‘KAJO’, ka rigrupuar të gjitha ish-uzinat ushtarake, si një kompani shtetërore ombrellë, e cila ka filluar të bëjë negociata me një seri investitorësh të huaj nga vende aleate për prodhime municionesh, uniformash, pse jo edhe prodhim dronësh.

Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, tashmë e ngritur dhe funksionale, e organizmit që do të mbikëqyrë, licencojë dhe monitorojë aktivitetin, në përputhje me rregullat dhe standardin e NATO-s.

Tashmë, 2/3 e fondeve të qeverisë shqiptare për mbrojtjen, e vitit 2025, janë dedikuar për rritjen e kapaciteteve, me fuqi zjarri, mjete ajrore, artileri, mbrojtje antidron. Jemi duke rritur gamën e armatimeve me të cilat po pajisemi, sikundër janë edhe sistemet antitank, investime të cilat nuk janë bërë prej dekadash.

Ministri Vengu: Riaktivizim i industrisë ushtarake, rritje të kapitalit njerëzor dhe luftarak Të barabartë përkrah **NATO-s**



Specialistët xhenerë të Kompanisë së Urave në Batalionin e Xhenios, përfunduan operacionin xhener për montimin e urës metalike tip “Bailey” në fshatin Fshat, në qytetin e Klosit.

Për një periudhë dyjavore ekspertët xhenerë, duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik gjatë transportimit të materialeve dhe montimit të urës, me përkushtim dhe profesionalizëm i dhuruan banorëve të fshatit Fshat, urën me gjatësi 27 metra dhe seksion 2/1, me peshëmbajtje 40 tonë.

Kjo urë e ndërtuar mbi lumin Lezëder, e cila lidh fshatin Fshat me atë Dars, do iu shërbejë 300 banorëve, duke lehtësuar jetesën e tyre të përditshme, njëkohësisht, duke i bërë më të prekshme shërbimet e ofruara në qendrat shëndetësore dhe shkollat e vendosura në këtë zonë. Komanda Mbështetëse vazhdon të japë kontributin e saj duke i ardhur në ndihmë popullsisë civile në të gjithë territorin e vendit.

Batalioni i Xhenios përfundon me sukses montimin e urës “Bailey” në bashkinë Klos





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një botë ku zërat e fuqishëm dhe mendimet e shumta mbizotërojnë çdo hapësirë, sa shpesh ndalemi të dëgjojmë njëri-tjetrin?

Sa herë u japim rëndësi atyre që nuk kanë një mikrofon në duar apo një platformë për t'u shprehur?

Zëri i Heshtur i Shoqërisë

Shpesh, në vorbullën e jetës, fjalët tona mbeten të pathëna, ndjenjat tona të paftuara dhe mendimet tona të pavlera. Shoqëria ka ndërtuar barriera të padukshme që ndajnë ata që dëgjohej nga ata që injorohen. Janë të rinjtë që luftojnë për të treguar potencialin e tyre, janë gratë që kërkojnë të kenë një zë të barabartë, janë njerëzit që përballen me sfida ekonomike e sociale, të cilët shpesh ndihen të padukshëm.

Por nëse ndalemi për një moment dhe dëgjojmë, do të kuptojmë se çdo njeri ka diçka për të thënë. Pas çdo shprehjeje ka një histori, pas çdo zëri ka një ëndërr, pas çdo heshtjeje ka një thirrje.

Fuqia e Dëgjimit

Dëgjimi nuk është thjesht një akt fizik, por një akt i ndjeshmërisë dhe mirëkuptimit. Kur dëgjojmë dikë me vërtetësi, i japim rëndësi, i pranojmë ekzistencën dhe e bëjmë të ndihet i vlerësuar. Një fjalë e dëgjuar mund të ndryshojë një jetë, mund të frymëzojë një shpirt, mund të sjellë drejtësi atje ku mungon.

Mendo për një mik që të ka dëgjuar kur ke qenë në nevojë. Mendo për një moment kur dikush të ka kuptuar pa të gjykuar. A nuk ishte ajo ndjesia më e çmuar? A nuk ishte ai një çast që të dha forcë për të vazhduar?

Të Dëgjojmë për të Ndërtuar Një Shoqëri më të Mirë

Një shoqëri që dëgjon është një shoqëri që zhvillohet. Kur dëgjojmë mendimet dhe shqetësimet e të tjerëve, krijojmë ura komunikimi, thyejmë paragjykimet dhe ndërtojmë një të ardhme më të drejtë.

Të dëgjosh një fëmijë, të dëgjosh një të moshuar, të dëgjosh një të panjohur, të gjitha këto janë hapa drejt një bote më humane.

“Dëgjomë dhe mua!” është një thirrje për të gjithë ne. Është një kërkesë për më shumë dhembshuri, për më shumë hapësirë për mendimet ndryshe dhe për më pak indiferencë. Nëse secili prej nesh zgjedh të dëgjojë më shumë sesa të flasë, ndoshta bota do të jetë një vend më i mirë për të gjithë.

Prandaj, para se të vazhdosh me jetën tënde, ndalu për një moment. Shiko përreth. Ndoshta dikush po të thërret me heshtjen e tij.

Dëgjomë dhe mua - Bashkë mund të ndryshojmë këtë botë

Në një botë ku shpesh ndihen vetëm zërat më të fortë, ku individ i zakonshëm duket sikur humbet në kaosin e shoqërisë, vjen një thirrje e thjeshtë, por e fuqishme: “Dëgjomë dhe mua!”. Kjo nuk është thjesht një kërkesë për vëmendje, por një apel për bashkëpunim, për ndryshim, për ndërtimin e një bote më të mirë.

Forca e Dëgjimit dhe Ndryshimit

Shumë njerëz ndihen të padukshëm në shoqëri, të paafektuar nga vendimet që merren mbi ta dhe shpesh të pashpresë për të ndryshuar diçka. Por historia ka treguar se çdo ndryshim i madh ka filluar me një zë të vetëm, me një person që guxoi të thoshte: “Dëgjomë dhe mua”.

Mahatma Gandhi dikur tha: “Ji ndryshimi që dëshiron të shohësh në botë”, por ndryshimi nuk vjen vetëm. Ai lind nga dialogu, nga dëgjimi i njëri-tjetrit, nga uniteti dhe nga gatishmëria për të ndërtuar diçka më të mirë.

Problemet që Kërkojnë Dëgjim dhe Veprim

Bota jonë sot përballlet me ndryshimet klimatike të cilat po



DËGJIMI NUK ËSHTË THJESHT NJË AKT FIZIK, POR NJË AKT I NDJESHMËRISË DHE MIRËKUPTIMIT. KUR DËGJOJMË DIKË ME VËRTETËSI, I JAPIM RËNDËSI, I PRANOJMË EKZISTENCËN DHE E BËJMË TË NDIHET I VLERËSUAR. NJË FJALË E DËGJUAR MUND TË NDRYSHOJË NJË JETË, MUND TË FRYMËZOJË NJË SHPIRT, MUND TË SJELLË DREJTËSI ATJE KU MUNGON.

shkatërrojnë natyrën dhe ekosistemet tona. Pabarazia sociale po rrit hendekun mes të pasurve dhe të varfërve. Edukimi dhe informacioni janë kyç për përparimin, por jo të gjithë kanë akses të barabartë.

Liria e fjalës dhe dëgjimi i të tjerëve shpesh kufizohen nga paragjykimet dhe polarizimi shoqëror. Nëse çdo zë do të dëgjohej dhe çdo ide do të merrej në konsideratë, sa ndryshe do të ishte bota?

Bashkë Mund të Ndryshojmë

Nuk është e nevojshme të jemi të fuqishëm, të pasur apo të famshëm për të bërë ndryshimin. Mjafton të fillojmë me hapa të vegjël: Dëgjo dhe respekto mendimin e të tjerëve. Ndryshimi fillon kur mësojmë të kuptojmë këndvështrimin e të tjerëve.

Bëhu zëri i atyre që nuk mund të flasin.

Ndihmo ata që janë të shtypur, të diskriminuar apo të harruar nga shoqëria.

Merr iniciativën për të mbrojtur mjedisin, për të ndihmuar një komunitet në nevojë apo për të luftuar për të drejtat e njeriut. Bashkëpunojmë për një qëllim të përbashkët. Një individ mund të bëjë ndryshime të vogla, por një grup mund të transformojë botën.

Kur dëgjojmë njëri-tjetrin, kur mbështesim njëri-tjetrin, ne e bëjmë këtë botë më të drejtë, më të ndershme dhe më të jetueshme për të gjithë.

“Dëgjomë dhe mua”, nuk është thjesht një thirrje për ndihmë, por një mesazh shprese dhe bashkimi. Bota nuk ndryshohet vetëm nga një individ, por nga një komunitet njerëzish të gatshëm të dëgjojnë dhe të veprojnë së bashku.

Nëse secili prej nesh ngrihet për të bërë diçka pozitive, atëherë, pak nga pak, ne mund ta ndryshojmë këtë botë. Sepse ndryshimi fillon me një ide, një zë, një person. A do të jesh edhe ti pjesë e këtij ndryshimi?

‘Dëgjomë dhe mua’, ti, si unë, por me mendim dhe qasje ndryshe, ‘ti’ vetëm mbetesh vetëm ‘ti’, dhe bota jote e vogël pa forcën për të bërë ndryshimin që e përditshmja kërkon.

“Dëgjomë dhe mua, dhe bota do marrë tjetër kuptim”, është një thirrje për të hapur zemrat dhe mendjet ndaj njëri-tjetrit. Është një ftesë për të ndërtuar një botë më të mirë, ku çdo zë ka vlerë, ku çdo histori mund të dëgjohej dhe ku çdo njeri ndihet i kuptuar.

Nëse sot fillojmë të dëgjojmë me vërtetësi, nesër bota do të jetë një vend më i ngrohtë dhe më njerëzor. Prandaj, dëgjomë dhe mua, sepse çdo zë ka një histori për të treguar.

Nëse shoqëria do të ndërtohej mbi bazën e dëgjimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, ndoshta do të kishte më pak konflikte dhe më shumë bashkëpunim. Një botë ku njerëzit dëgjojnë njëri-tjetrin do të ishte një botë më e drejtë, më e ngrohtë dhe më e mbushur me shpresë.

“Dëgjomë dhe mua, dhe rrugëtojmë së bashku” nuk është thjesht një frazë, por filozofi jete. Është një thirrje për më shumë empati, për më shumë bashkëpunim dhe për të ndërtuar marrëdhënie më të shëndetshme mes njerëzve.

Në fund të fundit, nuk është e rëndësishme vetëm sa larg arrijmë, por edhe kush ka qenë pranë nesh gjatë këtij udhëtimi.

A do të zgjedhim të dëgjojmë njëri-tjetrin dhe të ecim së bashku, apo do të vazhdojmë të ecim të vetmuar në një botë të zhurmshme? Zgjedhja është e jona.

Të dëgjosh, është shprehje e dashurisë dhe e respektit që është shumë e rëndësishme në marrëdhënie me tjetrin, si në jetën në çift, ashtu në jetën familjare e gjithashtu në marrëdhënie pune e në marrëdhënie shoqërore. Goethe thotë: “Të flasësh është e nevojshme, të dëgjosh është art”.

Të gjithë dinë të flasin, e të gjithë kanë nevojë të shprehen e të tregojnë për veten, për dhimbjet e kënaqësitë e veta gjithashtu të flasin edhe për të tjerët.

A janë të gjithë të aftë të dëgjojnë, apo të praktikojnë artin e të dëgjuarit?!

Të dëgjosh nuk është e lehtë, nuk është natyrale, por të dish të dëgjosh është art që nevojitet të mësohet.

Të dëgjosh të tjerët pa kaluar në paragjykim është një nga gjërat më të mira që mund të bëjmë.

Kur dëgjimi bëhet pa e mbyllur mendjen, zemrën ndaj të dashurve, kolegëve të punës, fëmijëve dhe ndaj personave që nuk janë shumë simpatik ose kujtdo tjetër, është e rëndësishme të dëgjoni se çfarë po thotë e kështu të dy palët do të përjetojnë një ndryshim të madh.

Ndihesh mirë kur dëgjon, dhe ndihesh mirë kur të dëgjojnë.

SHSHHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji uron 22-vjetorin e Krijimit të Brigadës së Stërvitjes në Bunavi, Vlorë

Me rastin e kremtimit të 22-vjetorit të Krijimit të Brigadës së Stërvitjes në Bunavi, sot Qendra e Arsimit Profesional të Ushtarit (QAPU), SHSHHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji përcjell urimet e tij për kontributin vyer në përgatitjen dhe forcimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura.

“Në këtë ditë të veçantë, shënojmë 22-vjetorin e krijimit të Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarit. Ky përvjetor është një mundësi për të reflektuar mbi arritjet, për të nderuar trashëgiminë e kësaj qendre dhe për të forcuar angazhimin tonë për të ardhmen.

Falënderimet e mia të veçanta shkojnë për drejtuesit, ushtarakët dhe instruktorët e kësaj qendre, të cilët ndër vite kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në përgatitjen e brezave të ushtarakëve të rinj. Profesionistët e përkushtuar të kësaj qendre kanë qenë dhe mbeten zemra e procesit stërvitor, duke siguruar që çdo rekrut dhe ushtarak i FARSH-së të jetë i gatshëm për misionet që i besohen.

Puna juaj në vite është një shembull frymëzimi dhe përkushtimi që meriton mirënjohje më të thellë dhe vlerësimin më të lartë.

Në këto vite, kjo qendër, ka përmbushur një rol kyç për strukturat tona ushtarake. Kjo qendër ka trajnuar dhe certifikuar breza të tërë ushtarakësh, të cilët kanë dhënë e po japin kontributin e tyre në strukturat e FARSH brenda dhe jashtë vendit. Arsimiti Profesional i Ushtarit, që zhvillohet në këtë qendër, mbetet porta hyrëse dhe baza themelore për përgatitjen dhe aftësimin bazë të personelit ushtarak, duke siguruar një standard të lartë për disiplinën, njohuritë dhe profesionalizmin e tyre.

Ndërsa vazhdojmë të përmirësojmë procesin arsimor dhe stërvitor, është thelbësore të intensifikojmë përgatitjen në këtë qendër për t’iu përshtatur sfidave të reja.

Situatat e brishta të sigurisë në rajon dhe më gjerë na kujtojnë përherë se stërvitja duhet të jetë e vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe e orientuar drejt misionit dhe përmirësimit të performancës, si nga instruktorët ashtu edhe nga rekrutët/kursantët.



Për këtë arsye, kemi rritur fokusin në përgatitjen taktike e operacionale për misione me spektër të plotë luftarak, duke ndihmuar që FARSH të mbetet një partner i besueshëm dhe i aftë për të përmbushur detyrimet e tij brenda NATO-s, OKB dhe në kuadër të angazhimeve me Bashkimin Evropian.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i punës suaj ka qenë angazhimi në mbështetje të komunitetit, veçanërisht në raste të emergjencave civile.

Ndihma e dhënë gjatë fatkeqësive natyrore dhe situatave të jashtëzakonshme, si zjarre, përmbytje, ka treguar përkushtimin dhe profesionalizmin tuaj në shërbim të qytetarëve

dhe të vendit.

Këto përpjekje, së bashku me aftësitë taktike dhe operacionale që zhvillonin në QAPU, janë dëshmi e rolit kyç që luani përballë kërcënimeve dhe sfidave të sigurisë në rajon dhe më gjerë. Në këtë përvjetor, është e rëndësishme të përmendet përkushtimi i qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Mbrotjtjes për të përmirësuar kushtet financiare dhe infrastrukturore për ushtarakët dhe rekrutët e rinj.

Këto përmirësime kanë reflektuar një interes në rritje për të shërbyer në FARSH, një tregues i besimit në vizionin tonë dhe në përpjekjet tona për të ndërtuar një forcë moderne, të aftë, të besueshme dhe kontribuuese themelore në sigurinë kombëtare dhe në angazhimet ndërkombëtare.

Duke përfunduar, dua t’ju siguroj se Shtabi i Përgjithshëm i FARSH do të mbetet gjithmonë i angazhuar për t’ju mbështetur në çdo hap të aktivitetit tuaj.

Urime për këtë përvjetor të 22-të dhe suksese të mëtejshme në misionin tuaj fisnik!

Ju falënderoj për gjithçka që keni bërë dhe vazhdoni të bëni për forcimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe për sigurinë e vendit tonë”.





Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve është krijuar në shkurt të vitit 2003 me emërtimin Brigada e Stërvitjes Bazë, si institucion i trajnimit të ushtarëve të rinj të FA të RSH. Në shtator 2003 ka filluar kursi i parë me 550 ushtarë. Me kalimin e viteve ka ndryshuar emërtimi i institucionit si Qendra e Stërvitjes Individuale, Shkolla e Trupës, Shkolla e Trupës dhe Qendra e Stërvitjes Individuale, por thelbi i këtij institucioni ka qenë trajnimi i të rekrutuarve në FA, ku përfshihen kandidatët për ushtarë/detarë por edhe kandidatët për oficerë në disa vite. Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve (QAPU) aktualisht është institucioni i vetëm ushtarak, i cili përgatit dhe trajnon të gjithë kontingjentet e kandidatëve për ushtarë/detarë dhe ushtarëve në të dy komponentët e Stërvitjes Individuale, Stërvitjen Individuale Bazë dhe Stërvitjen Individuale të Avancuar.

Në fakt ky repart konsiderohet i “vjetër” për historikun e FA-ve të Republikës së Shqipërisë, pasi zanafilla e tij është në vitin 1964 dhe prej këtij viti reparti është transformuar në strukturë, infrastrukturë, emërtim, mision dhe sot konsiderohet një repart modern dhe i konsoliduar, duke përbushur me sukses misionin e ngarkuar.

QAPU: Drejton dhe menaxhon zhvillimin dhe vlerësimin e Stërvitjes Individuale Bazë me rekrutët kandidatë për ushtarë/detarë aktivë dhe Stërvitjes Individuale të Avancuar me ushtarët sipas specialiteteve.

Qendra e Arsimit Profesional të Ushtarëve është e dislokuar në territoret e dy njësive administrative të Bashkisë Vlorë, njësisë administrative Qendër dhe njësisë administrative Shushicë, në koordinatat gjeografike: Φ 41°31’10”, Λ 19° 30’43”.

- **Baza e Bunavisë është krijuar në vitin 1964 si Batalion Këmbësorie**
- **Në vitet 1985-1990 ka funksionuar si Shkollë Instruksioni për përgatitjen e oficerëve në rezervë.**
- **Në vitet 1991-1996 ka funksionuar si Brigadë Këmbësorie.**
- **Në vitet 1996-2003 ka funksionuar përsëri si Batalion Këmbësorie.**
- **Në shtator 2003 është krijuar Brigada e Stërvitjes Bazë.**
- **Në vitin 2010 është krijuar Qendra e Stërvitjes Individuale.**
- **Nga tetori i vitit 2012 deri në tetor të vitit 2020 ka funksionuar si Shkollë Trupe.**
- **Nga tetori i vitit 2020, emërtohet Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, duke vijuar me po këtë emër.**

Në rrugën e gjatë që nga krijimi dhe deri në ditët e sotme reparti ka pësuar ndryshime të rëndësishme dhe domethënëse falë përkujdesjes së Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm, Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes sot

22 VITE KONTRIBUT dhe vizion i QAPU në trajnimin e personelit ushtarak të FA

Akademia e Forcave të Armatosura.

Në këtë rrugëtim plot sfida dhe vështirësi padyshim kontribut të qenësishëm kanë dhënë personeli i saj në vite që nga ushtari më i thjeshtë, nënoficerët, punonjësit civil dhe oficerët e të gjitha niveleve.

QAPU, në nivel kombëtar, përfaqëson një aset me vlerë, serioze dhe të besueshme, profesionale dhe të aftë të përbushë detyrimet në përgatitjen e ushtarit profesionist të së ardhmes dhe synon të ofrojë standarde, cilësi, përgatitje bashkëkohore dhe përshtatje me kërkesat e Forcave të Armatosura dhe nevojave të tjera në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Bunavia ofron: akomodim, ushqim, larje, mjedise çlodhje dhe argëtimi, poligone për zhvillim të qitjeve, poligone të stërvitjes taktike, terrene sportive, sheshe dhe rajone stërvitore për çdo temë që zhvillohet, klasa, armatim dhe pajisje luftarake, bazë materiale dhe didaktike për stërvitje, shërbim shëndetësor 24 orë, furnizim me ujë, personel me eksperiencë në zhvillimin e programeve të ushtarit.

Kushtet jetësore

Akomodimi: Kapaciteti i përgjithshëm akomodues 500-600 vetë, 2 godina 3-katëshe të rikonstruktura në vitet 2003-2004,





dhe një godinë 4 kate (hotel) ndërtuar e re në vitin 2007.

Ushqimi: Në Bunavi funksionojnë kuzhina e gatimit, dhe mensa 2 kate me kapacitet 300 vende, të zgjeruara dhe rikonstruktura në vitin 2007. Gatimi dhe shpërndarja e ushqimit prej vitit 2007 bëhet me kontraktor privat.

Larja: Në garnizon funksionojnë dy kaldaja për larjen e efektivave, me naftë dhe gaz dhe një me panele diellorë, si dhe dushe të mjaftueshëm për larjen e efektivave. Larja e çarçafëve dhe teshave të ushtarëve bëhet me kontraktor privat.

Mjedise çlodhëse dhe kulturore: Në garnizonin Bunavi funksionon biblioteka me një fond të pasur librash dhe revistash artistike dhe gjithë literatura ushtarake e botuar nga FARSH. Gjithashtu, ka salla televizori, terrene sportive (fushë futbollit, minifutbollit, volejbollit, sallë force, mjediset janë të asfaltuara dhe përdoren gjerësisht për vrapim), ku mund të luajnë e të argëtohen dhjetëra kursantë njëkohësisht.

Infrastruktura stërvitore dhe kapacitetet e saj

Poligone për përgatitjen dhe zhvillimin e qitjeve: Në garnizonin Bunavi funksionojnë poligonet e qitjes për zhvillimin e përgatitjes për qitje me armët e këmbësorisë dhe zhvillimin e tyre të përshtatura për të gjithë qitjet që parashikohen në programet e SIB dhe SIA, si: qitjet me skuadër në mbrojtje dhe qitjet bashkërenduese në sulm. Në poligonet e qitjes realizohen qitjet me granata dore luftarake, qitjet me GHLKT, qitjet me mitraloz të lehtë dhe qitjet me automatik deri 200m. Qitjet natën realizohen në poligonin e qitjes natën. Qitjet me pistoletë realizohen në poligonin themelor. Në interes të përgatitjes së grupeve mësimore janë përshtatur dhjetëra sheshe për përgatitjen për qitje.

Poligone të stërvitjes taktike: Janë përshtatur sipas temave të programit SIA tre poligone taktike (nivel ushtar/skuadër/togë), poligoni i operacioneve mbrojtëse, i operacioneve mësymëse, operacioneve asimetrike (pika e kontrollit, prita, lufta në qendrat e banuara, etj.).

Terrenet e përgatitjes fizike: janë në funksion Brezi i Kalitjes fizike me 12 elementë, vegla gjimnastikore, sheshi i luftimit trup me trup, fusha e futbollit, pista e vrap, kalçeto, fushë basketbolli, volejbollit.

Sheshe dhe rajone stërvitore: Sheshet dhe rajonet stërvitore mundësojnë zhvillimin e programeve të MKK, Xhenios, Topografisë, Ndërlidhjes. Ka dy sheshe të mëdha rreshtimi të asfaltuara, ku zhvillohen në kushte shumë të mira temat e përgatitjes rreshtore.

Klasa: Vetëm në godinën e kursit SIA funksionojnë 4 klasa me kapacitet 30 vende dhe, po kaq të tilla janë në godinën e kursit SIB, dy salla me kapacitet 60 vende. Në godinën katërkatëshe janë nga 4 klasa në tre katet e kësaj godine Në godinën e bibliotekës funksionojnë 2 salla me kabinetet e gjuhës angleze (funksionale) me nga 20 vende, si dhe një kabinet për armët e zjarrit me kapacitet 30 vende.

Armatimi, Teknika dhe Pajisjet luftarake: Në Bunavi mbështet me armatim, pajisje luftarake i gjithë programi stërvitor i SIB dhe SIA-s për specialitetin këmbësori, logjistik, shëndetësi.

Baza materiale e didaktike për stërvitjen: baza materiale e lëvizshme ekzistuese në Bunavi mbështet pothuajse plotësisht programet e SIB dhe SIA-s për specialitete Këmbësori, MKK,

Xhenio, Ndërlidhje, Logjistikë, Polici Ushtarake, Shëndetësi, etj.

Programet e përgatitura për të gjitha specialitetet, dhe kohëzgjatja e tyre

Qendra e Arsimitit Profesional të Ushtarëve zhvillon dy programet e Stërvitjes Individuale të cilat janë: Programi i Stërvitjes Individuale Bazë, i cili zhvillohet me të rekrutuarit rishtas në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Programin e Stërvitjes Individuale të Avancuar sipas specialiteteve dhe që kryhet nga ushtarët që kanë kryer Stërvitjen Bazë, përjashtuar specialitetin “Detari”.

Programi i Stërvitjes Individuale Bazë (SIB) është 10 javë kalendarike ose 53 ditë stërvitore. Qëllimi i këtij programi është transformimi i civilëve të rekrutuar në FA në individë me disiplinë ushtarake, të motivuar, të përgatitur moralisht dhe fizikisht në përmbushjen e detyrave operacionale deri në nivel grupi. Programi mësimor ka 12 lëndë dhe në përfundim të këtij programi nga pjesëmarrësit kërkohet të arrihen disa standarde si: Përdorimi me lehtësi i armëve të lehta të këmbësorisë; Rezultate të mira në qitje; Performancë e mirë në zgjidhjen e detyrave operacionale nga niveli individual deri në nivel grupi; Nivel i lartë kondicioni fizik për çdo rekrut. Përgatitje fizike çdo ditë në program.

Në fund të çdo periudhe rekrutët testohen në detyra të ndryshme për çdo lëndë mësimore. Kursantët që nuk arrijnë standardet nuk kualifikohen.

Programi i Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA) është 10 javë kalendarike ose 50 ditë stërvitore. Zhvillohet me ushtarët aktiv që kanë kryer SIB, përjashtuar specialitetin detari.

Qëllimi i këtij programi është përgatitje ushtarake, fizike, psikologjike për çdo ushtar aktiv në situata luftimi për të zhvilluar detyra operacionale nga niveli individual deri në nivel skuadre.

SIA zhvillohet në specialitetet: Këmbësori, Logjistikë, Ndërlidhje, Polici Ushtarake, Xhenio.

Përparësitë e procesit certifikues nga Qendra e Arsimitit Profesional të Ushtarëve

Krahasuar me njësitë e repartet e FA, Qendra e Arsimitit Profesional të Ushtarëve garanton infrastrukturën jetësore dhe stërvitore sipas standardeve, me kapacitete dhe cilësi më të larta se në njësi/reparte të FA; ofron përvojën e duhur për trajtimin e kursantëve dhe zhvillimin e stërvitjes individuale me ushtarët profesionistë në të dy komponentët e saj, SIB dhe SIA; ofron kushtet optimale për zhvillimin e stërvitjes së ushtarit profesionist me regjim 24 orësh dhe sipas standardeve të përcaktuara, duke i krijuar mjedisin e duhur për trajtim e trajnim të njëlojtë për të gjithë trupën e ushtarëve të FA-së, (në pikëpamjet të procedurave të trajtimit, procedurave të zhvillimit të stërvitjes dhe testimit); garanton një proces dhe produktivitet më cilësor të stërvitjes, pasi kryhet e përqendruar në një strukturë të vetme dhe të specializuar stërvitore dhe jo e fraksionuar në qendrat stërvitore në njësitë e repartet e FA-së; ofron një trupë instruktorësh me eksperiencë shumëvjeçare në zhvillimin e kësaj stërvitjeje, ofron mjedise e kapacitete stërvitore të bollshme për stërvitjen sipas standardeve, ofron mjedise çlodhëse të bollshme dhe në standarde optimale,

Vizioni për të ardhmen e Qendrës së Arsimitit Profesional të Ushtarëve

Qendra e Arsimitit Profesional të Ushtarëve vijon të jetë qendër trajnimi për të gjithë kandidatët që rekrutohen në FARSH. Do të zhvillojë dhe konsolidojë më tej nivelin e përgatitjes së ushtarit të FA-së në dy komponentët e saj Stërvitjen Individuale Bazë dhe Stërvitjen Individuale të Avancuar.

Zhvillimi i stërvitjes Individuale të ushtarit në të dy komponentët e saj SIB dhe SIA të bëhet vetëm në QAPU, Bunavi.

Tre kurset SIB zhvillohen gjatë një viti me 156 rekrutë për secilin kurs dhe tre kurse të SIA me nga 120 ushtarë për secilin kurs, sa kapacitetet aktuale trajnuese të tyre. Me produkt vjetor 468 rekrutë në SIB dhe 360 ushtarë në SIA, ose gjithsej 828 të trajnuar.

Realizimi i një planifikimi konkret, objektiv dhe të realizueshëm, në termat afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, mbështetur në burime të mjaftueshme në aspektin e kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore, kurrikulare e programe, me qëllim zhvillimin e suksesshëm të programeve të stërvitjes individuale, do të bëhet nëpërmjet përqendrimit në objektiva konkretë të cilët do të përfshijnë tre drejtimet kryesore: Struktura; Infrastruktura/modernizimi; Programe.

Në aspektin strukturor, synohet forcimi i strukturës aktuale (faza e parë) dhe pas një periudhe 2-3-vjeçare (faza e dytë), rishikim i saj, me qëllim përcaktimin e saktë të përgjegjësive të QAPU, si dhe lidhjen e gjithë sistemit të stërvitjes të FA-ve me QAPU-në.

Një nga objektivat madhorë do të jetë infrastruktura, ndërhyrjet, përshtatjet në objektet kryesore ku akomodohen efektivat, përmirësimi i kushteve të jetesës të efektivave dhe modernizimi.

Kjo nismë është nevojë e rëndësishme e QAPU-së dhe në përputhje me vizionin dhe planin afatmesëm dhe afatgjatë të FARSH-së, me synim që të arrijë: sigurimin e hapësirave të nevojshme me infrastrukturë bashkëkohore për stërvitje, trajnim, argëtim dhe shërbime të tjera ndihmëse, në funksion të përmbushjes së misionit të QAPU-së dhe detyrave që rrjedhin prej tij: përmirësimin e kushteve të punës, jetesës, shëndetit, procesit stërvitor dhe sigurisë së personelit, në funksion të cilësisë së stërvitjes, trajnimit dhe kualifikimit.

Qendra e Arsimitit Profesional të Ushtarëve synon që ndërhyrjet në infrastrukturën aktuale por edhe ndërtimet e reja, modernizimi i ambienteve akomoduese, mjeteve të transportit, armatimit të ri të përfundojë brenda një periudhe 10-vjeçare e ndarë në tre faza, të cilat do të zhvillohen bazuar në master-planin aktual, hartimin e projekteve përkatëse dhe financimin e tyre në vite.

Në kushtet e transformimit dhe konsolidimit të plotë institucional, QAPU do të ketë si përparësi që zhvillimi kurrikular dhe ai i programeve të bëhet me synim: ndryshimet e nevojshme të diktua nga problematikat e evidentuara gjatë zbatimit në praktikë të programeve dhe mësimave të nxjerra, harmonizimin e programeve me kërkesat dhe nevojat e stërvitjeve pasardhëse në repartet operacionale. Përshtatja e tyre me kërkesat, standardet dhe eksperiencat e reja që ofrojnë veprimet luftarake në ditët e sotme.

Me infrastrukturën që ka pozicionin e saj gjeografik baza e Bunavisë duhet vlerësuar dhe përdorur jo vetëm për misionin aktual që ka por edhe për stërvitjen bazë/fillestare të kontingjenteve që hyjnë rishtazi në strukturat e tjera ligjzbatuese, apo edhe më gjerë.

GJURMË LUFTIMESH TË NJËSIVE SHQIPTARE NË BOSNJE



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Shqipëria ishte çliruar, por luftimet vazhdonin në ish-Jugosllavi. Në janar 1945 shtabi i DVIS, me përfundimin e operacionit në Mal të Zi, planifikoi masa luftarake për marshimin e brigadave sulmuese në ndjekje të armikut në tokën Jugosllave. Marshimi do kryhej në drejtimin e përgjithshëm: Kolashin-Bjellopolje-Plevlje-Rudo-Vishegrad. Lëvizja e forcave partizane do kryhej në terren të panjohur dhe në goditje të befasishme të armikut, ndaj u dhanë udhëzime që njësitë sulmuese të lëviznin në kolonë me masa mbrojtëse duke nxjerrë pararojë, praparojë, sigurim të krahëve me roja partizane tej. Në bazë të urdhrin të shtabit të DVIS, më 31 dhjetorit 1944, filluan lëvizje nga Mali i Zi në drejtim të Bosnjës BrVIIS, BrVIIIS, BrXXIIS dhe pas tyre shtabi i divizionit me BrVIS. Më 10 janar 1945 divizioni u përqendrua në qytetin e Plevljes dhe rrethinat e tij.

Më 14 janar 1945, forcat e BrVIS me BrXXIIS morën urdhër të rrethonin e të asgjësonin forcat çetnike rreth 1.500 veta në zonën Bugje-Megjeres, që gjendej midis Plevljes e Kudos përgjatë rrugës për në Vishegrad. Duke zbatuar urdhrin, brigadat mbërritën në vendet ku mendohej se ishin përqendruar forcat, por ato nuk gjendeshin aty. Ishin larguar përpara dy-tri ditësh në drejtim të Vishegradit, për të mos rënë në rrethim, si në rrethimin e kapjes së Pribojit, (jo larg, në lindje të Rudos) nga DVS i UNÇSH. BrVIS me BrXXIIS, u vunë në ndjekje, por u penguan nga ura e prishur nga çetnikët mbi lumin Lim në Ustibar. Ato qëndruan aty derisa këto u ndreqën edhe me ndihmën e popullsisë vendase. Mbas dy ditësh u nis prej Plevljas në Vishegrad dhe BrVIIS, ndërsa BrVIIIS qëndroi rezervë të shtabit të divizionit. DVIS përfundoi në kohë marshimin dhe u vendos në gatishmëri për të filluar operacionin për në Vishegrad.

Me çlirimin e Prijepoljes, në Vishegrad, ishte përqendruar Divizioni 181 i Korpusit XXI gjerman, i cili ishte tërhequr nga Shqipëria duke kaluar nga Mali i Zi, ndërsa trupa të tjerë të korpusit po vijonin rrugën për në Sarajevë. Në Dobrunje ndodhej Divizioni 22 gjerman. Ndërsa në Vishegrad ishin përqendruar dhe mijëra çetnikë. Vija e parë e mbrojtjes e armikut ishte pozicionuar në Strmica, Çeçiç, Drinsko, Suhagora, Poljanje Bjello-Rudo. Vija e dytë e trupave gjermane kalonte në pozicione të forta në rrugën Dobrun-Vishegrad dhe në qytetin e Vishegradit.

Vishegradi një qendër e banuar përbënte një kyçe në frontin e Juglindjes. Forcat gjermane ishin përqendruar në vijën Drina-Vishegrad-Mostar dhe mbahej me këmbëngulje prej tyre, pas tërheqjes së trupave gjermane nga Shqipëria dhe Serbia. Ushtrisë së Kuqe gjendej në Hungari dhe kishte zënë një front që shtrihej në rrjedhën e lumit të Dravës. Rajoni i Vishegradit përbënte portën kryesore për në Sarajevë, dhe kërkohej të mbahej nga gjermanët sa më gjatë.

Më 19 janar 1945 BrVIS dhe BrXXIIS i ishin afruar Vishegradit 7 km në jug dhe 9 km në juglindje. Ndërsa BrVIIS e DVIS po afrohej dhe do kalonte në mësimje në hapësirën prej 20 km, të krijuar nga forcat e divizioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë. DVIS kishte për detyrë luftarake asgjësimin e forcave gjermane dhe çlirimin e Dobrunin dhe qytetin e Vishegradit. Goditjen kryesore do jepej nga forcat e BrVIIS dhe BrXXIIS, në drejtimin Poljanicë-Dobrun-Vishegrad. Ndërsa BrVIS do mësonte në drejtimin Strmica-Drinsko. Urdhri i operacionit i shtabit të DVIS parashikonte që brigadat gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake, të bashkëvepronin dhe të vendosnin ndërlidhjen me repartet e Ushtrisë Jugosllave.

BrXXIIS kishte zënë pozicione në Suhagora e Černivce (në



jug të Dobrunjës) dhe në mëngjesin e 20 janarit u hodh në sulm kundër mbrojtjes gjermane. Luftimet u zhvilluan të ashpra, forcat gjermane bënë qëndresë dhe detyruan dy batalione të brigadës ta ndalnin sulmin. BrVIS sulmoi pikëmbështetjet armike në Çaçiç e në Drinsko, në jug të Vishegradit. Sulmi i befasishtëm bëri që armiqët të lëshonin pikëmbështetjet në sektorin Vishegrad-Megjegj, dhe brigada iu afrua Vishegradit. Forca të brigadës goditën dhe shpartalluan çetnikë që drejtoheshin nga oficerë gjermanë.

BrVIIS hyri në veprim në zonën midis BrXXIIS dhe BrVIS, ku një batalion i saj sulmoi armiqët në malin e Suhagorës. Sulmi, u përsërit dhe të nesërmen me pjesëmarrjen dhe të një batalioni tjetër. Në krahun e djathtë të tyre sulmonte një batalion i BrXXIIS, ndërsa në të majtë një batalion i BrVIS. Mësimja përfundoi me shpartallimin e armiqve, të cilët u tërhoqën për në Vishegrad dhe lanë në tërheqje armë, materiale dhe rob. Armiqët u hodhën në kundërsulm për të ripushtuar majën më të lartë të malit të Suhagorës, ata arritën të rimerrnin pjesë të pozicioneve, por sulmi i partizanëve i theu trupat hitleriane. Gjithë dita kaloi me përleshje të përgjakshme. Përfundimi ishte se forcat partizane i ishin afruar Vishegradit. BrVIIS, më 23 janar gjendej 3-4 km nga juglindja e Vishegradit. BrVIS shpartalloi një grup hitlerianësh në Çaçiçin dhe përforcoi pikëmbështetjet përgjatë lumit, nga ku qëllonte me mitraloza trenat transportues të armikut që kalonin në Drinës.

Më 23 janar forcat e DVIS kishin rrethuar Vishegradit. Përballë



ARMIKU E PËRSËRITI
SULMIN ME FORCA DHE
MË TË MËDHA DITËN
TJETËR, KU BASHKË ME
GJERMANËT MERRNIN
PJESË DHE ÇETNIKË.
SULMI I TYRE U
MBËSHTET NGA ZJARRI
I DENDUR I ARTILERISË.
LUFTIMET U ZHVILLUAN
TË ASHPRA DHE
ZGJATËN RRETH TETË
ORË DHE PËRFUNDUAN
ME THYERJEN E
ARMIQVE E ME DËME TË
MËDHA PËR TA.

kërcënimit për Vishegradin komanda gjermane ndërmori një varg kundërsulmesh. Më 23 janar forca të mëdha armike u hodhën në veprim, nga Vishegradi anës së djathtë të lumit Drina, kundër BrVIS, e cila ishte bërë pengesë për komunikacionin hekurudhor Vishegrad-Sarajevë. Luftuan të rimerrnin Drinskon e Çaçiçin, por dështuan. Luftëtarët e brigadës jo vetëm e ndalën sulmin e armikut, por i mori krahët dhe filluan rrethimin, ndërsa gjermanët për t'i shpëtuar rrethimit u tërhoqën. Armiku e përsëriti sulmin me forca dhe më të mëdha ditën tjetër, ku bashkë me gjermanët merrnin pjesë dhe çetnikë. Sulmi i tyre u mbështet nga zjarri i dendur i artilerisë. Luftimet u zhvilluan të ashpra dhe zgjatën rreth tetë orë dhe përfunduan me thyerjen e armiqve e me dëme të mëdha për ta. Pushtuesit gjermanë më 24 janar kryen sulm dhe kundër forcave të BrVIIS, për të rimarrë majën më të lartë të Suhagorës, ku u thyen si sulmi i parë ashtu dhe sulmi i dytë i tyre, ku pati mjaft humbje.

Kundërveprimin më të madh gjermanët e bënë kundër luftëtarëve të BrVIS për të rimarrë Drinskon e Çaçiçin. Forcat partizane i qëndruan me heroizëm sulmit që ndërmorën armiqët dhe i detyruan nazistët të tërhiqeshin pa arritur qëllimin. Edhe BrVIIIS përgatitej të hynte në luftim me qëllim që të kryente një varg sulmesh të fuqishme me batalione kundër pikëmbështetjeve gjermane anës Drinskos, që mbronin qytetin dhe hekurudhën. Mirëpo krejt papritur shtabi i DVIS të UNÇSH, më 29 janar, mori nëpërmjet shtabit të Korpusit II Jugosllav urdhrin e Komandës së Përgjithshme të UNÇJ për të ndërprerë veprimet e për t'u kthyer në Shqipëri.

Shtabi i këtij divizioni, duke shprehur ndjenjat e gjithë kuadrove e të partizanëve të njësisë lidhur me këtë urdhër, më 30 janar, shkruante: "...cilado qoftë arsyeja për të cilën shkojmë në Shqipëri, gjithë pjesëtarët e DVIS, nga njëra anë, dëshpërohen pasi vullneti i tyre është i pathyeshëm me vazhdue përpara deri në fitoren e plotë kundër nazizmit e shërbëtorëve të tij, por nga ana tjetër, jemi të sigurt e kryelartë për kryerjen deri këtu të misionit që na ishte ngarkuar. Grushte vdekjeje i dhamë armikut kudo që kaluam".

Njëkohësisht, shtabi i DVIS njoftoi me radiogram Komandën e Përgjithshme të UNÇSH-së për urdhrin e shtabit jugosllav. Në mbremje urdhri qe anuluar. Brigadat nuk do të lëviznin nga vendi ku ndodheshin: ato do të vazhdonin veprimet. Urdhri i shtabit jugosllav u anulua me ndërhyrjen e Komandantit të Përgjithshëm të UNÇSH-së. Dëshpërimi i kuadrove dhe i partizanëve të DVIS u shndërrua në gëzim. U përforcua dhe më shumë vendosmëria e tyre për të luftuar duke ndjekur ushtrinë gjermane deri në Berlin. Edhe në veprimet e mëtejshme për çlirimin e Vishegradit jugosllavët u nxorën shumë pengesa.

Kështu u luftua 80 vjet më parë nga luftëtarët shqiptarë në ndihmë të popujve të ish-Jugosllavisë. Nder dhe lavdi në shekuj për rrugën luftarake që përshkuan mes sakrificave dhe gjakut të derdhur për fitoren e Koalicionit Antifashist Botërore.



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

*Tani jemi bërë,
Gjyshër-baballarë,
Po s’harrojmë kurrë,
Strehëzën e parë.*

*Mbanim fushat-malet,
E gjithë Shqipërisë,
Prag i asaj shkolle,
Si pragu i shtëpisë.*

*Për jetë të gdhendur,
E kemi në ballë,
Jemi skënderbegas,
Sa të jemi gjallë.*

Vargjet e të madhit Arben Duka janë mishërimi i jetës, miqësisë dhe dashurisë të pakusht të djelmoshave “Skënderbegas”, të cilët ende e ruajnë po kaq të pastër respektin për njëri-tjetrin. Një prej tyre është dhe ish-skënderbegasi Veri Taushllari, i cili shpesh për lexuesin e shtypit “Ushtarak” sjell copëza jete të kësaj shkolle elitë dhe njerëzve të dalë prej saj, të cilët kanë shkëlqyer në të gjitha fushat ku kanë dhënë kontributin e tyre.

Çast nga jeta “Skënderbej”

Mësuesi i Letërsisë vendosi fletoret e hartimit mbi tavolinë dhe i hodhi klasës një vështrim nën syzet e errëta optike. “Hë, si thoni djema, do të bëjmë korrigjim hartimi sot?” Pyetja ishte e kotë se ne do të bënim ç’të thoshte ai. U mbështet te tavolina, kryqëzoi duart në gjoks, hodhi këmbën e djathtë mbi të majtën dhe pas një pauze foli: “Keni bërë hartime të bukura çuna. Keni shkruar me ndjenjë, keni shtrydhur zemrën”. “Tema profesor”, foli dikush. “E drejtë, po, mund të ketë ndikuar dhe tema. Ishte një temë e bukur: për nënën”. “Ju jeni si një filad/kur puthni lehtë fëmijët/ por ktheheni në tallaz/kur dikush u prek lirinë!”, - ja, kjo ishte tema! Shkruanim e gjithsecilit i ushtonte në veshë zëri i Vaçe Zelës a i Mentor Xhemalit, e duke ndjekur atë zë, frazat në letër rridhnin vërtet si të shtrydhje zemrën!

Ishim në vitin e parë të Shkollës SKËNDERBEJ, kishim vetëm pak kohë që kishim veshur uniformën e blertë, dhe pse ta mohojmë, na kish marrë malli për shtëpinë, e, kuptohet, më shumë për nënën. Mësues Myzafer Ramzoti sikur të kish qenë në zemrat tona kur na dha atë temë! Interesant, ka më se 50 vjet që ka ndodhur kjo



ngjarje dhe para syve e kam me detaje. Pse? Sepse atë ditë kam njohur me të vërtetë shokun tim, një nga më të mirët shokë që kam pasur në vitet e shkollave ushtarake por edhe më pas, në vitet si oficer. E për një çudi a rastësi, edhe kur emigrova në SHBA, e sot e kësaj dite: Petrit Zanin. Në këto më se pesë dekada kemi patur plot e plot ngjarje të përbashkëta të jetës sonë, në Shkollë por edhe pas saj, në hallet dhe gëzimet e njëri-tjetrit...

Por ajo njohja e parë e vërtetë, kuptohet që ne e njohëm njëri-tjetrin që në ditët e para kur u mblodhëm në klasë ose në togën e 1/7 ato ditë shtatori të vitit 1971, ajo orë hartimi me temë për nënën, do të mbetet e paharruar. “Kam këtu shumë hartime të bukur, - vazhdoi mësues Myzaferi, - dhe do t’u lexoj disa”. Mua m’u skuqën veshët kur tok me emrat e Xheladin Çelmetës dhe Agim Canit lexoi dhe emrin tim. “Por hartimin më të bukur e ka bërë Petriti. Dëgjojeni!”. E dëgjuam. E dëgjuam dhe mbetëm...pa gojë. O ç’shpiert kish ai njeri! Det t’i thoshe atij shpirti, furtunë t’i thoshe, këngë t’i thoshe, a ç’ti thoshe! Ishte një tregim që fliste për ca zogj të vegjël që nëna e tyre i shpëtoi nuk më kujtohet nga ç’rrezik a e keqe, duke luftuar e sakrifikuar veten e... ç’ta zgjas, e thashë njëherë, mbetëm gojëhapur! Hartimet që lexoi më pas mësuesi, ishin sikur i recitonte nuk më bënë më përshtypje. Mendja më rrinte tek ai hartim.

Tek shpirti i madh i atij djaloshit të gjatë e të thatë vlonjat që tani e shihja me një sy, me një ndjenjë krejt tjetër. Dhe prej asaj ore nuk di pse i besova atij njeriu, i besova shpirtit të tij të bukur, zemrës së tij të mirë. Besova se ky djalosh do të bënte vetëm gjëra të mira në jetë. Dhe nuk u zhgënjeva. Nuk u zhgënjyen edhe shokët e mi, që edhe ata e kanë dashur e besuar si unë. Vite më vonë, në maturë dhe Shkollën e Lartë, kur më thoshte “E si thua, do bëjmë një këngë zemre? Na bëj një tekst të bukur!”, nuk kisha zemër t’i thosha jo. E dija që do të bënte këngë të bukur! Dhe çudi, nuk i dinte ligjet e kompozimit, madje edhe sot dyshoj në i di mirë edhe notat, por atij kënga, e gëzuar apo e trishtuar, i dilte nga shpirti,

i këndonte zemra! Dhe bënte vërtet këngë të ndjera. Pas shumë e shumë vitesh, kur u mblodhëm familjarisht në shtëpinë e tij në Filadelfia, bashkëshortet dhe fëmijët tanë u befasuan kur ne kujtuam e kënduam një këngën tonë, një këngë malli për një vajzë që djali mezi priste ta rrëmbente në krahë në një qytet mes një deti dritash e... Por ne bëmë edhe Himnin e Artijerit Kundërajror, një këngë që mbase edhe për meritë të komandantit tonë të baterisë e më pas edhe i GrAKA në Shkollën e Lartë të Oficerëve, Sazan Matlliu, që ua mësonte brezave të studentëve pasi mbaruam studimet, u këndua në repartet kundërajrore të Ushtrisë deri në vitet 2000.

Por le t’i kthehemi hartimit tonë. Ndërsa mësuesi lexonte, Petriti kish ulur kokën. Dhe ishte një çast aty nga fundi i hartimit që ai vështroi mësuesin dhe bëri me dorë si të thoshte “Lëre profesor...”. Ishte pjesa më e bukur, më prekëse. Befas seç më shkrepri në kokë: ai ose e ka nënën të sëmurë ose... ose... E për fat të keq ishte e vërtetë ajo që nuk doja as ta mendoja: Nëna e kish lënë të vogël! Bashkë me motrën dhe vëllain. Të gjithë u prekëm kur e dëgjuam. Nuk ka nevojë ta them sa e ndjente mungesën, përkëdhelinë e saj. Ja pse ai hartim ishte shkruar me aq ndjenjë! Ndaj dhe siç thashë, besova se prej tij s’mund të prisje veçse mirësi. Dhe ashtu ndodhi vërtet. Petriti i mbaroi shkëlqyeshëm studimet në të dy Shkollat Ushtarake, dhe, pas një karriere të shkurtër në terren, u emërua pedagog në Shkollën e Lartë të Oficerëve, në Katedrën e AKAs. Rrethanat, ose të themi të ashtuquajturat reforma të Ushtrisë pas viteve ‘90, e detyruan të emigronte fillimisht në Greqi e më pas në SHBA. U ndërpre një karrierë që me siguri do të ishte e ndritur. Në Filadelfia Petriti, krahas punës, u diploma me rezultate të shkëlqyera në një Universitet të njohur për Administrim Biznesi, profesion që e ushtron edhe sot, kur po i afrohet të 70-ve. Por, duke mbetur gjithnjë ai Petriti punëtor, i zgjuar, zemërmirë, atdhetar, iu bashkua Shoqatës Atdhetare “Bijtë e Shqipes”, padyschim shoqata më e organizuar, më aktive, më e suksesshme sot në SHBA. Petriti është një nga shtyllat e saj. Jo vetëm si Kryetar për dy vjet, por edhe si administrator me dorë të hekurt i financave të saj. Dhe jo vetëm kaq. Së bashku me disa kolegë oficerë, edhe ata me banim në Filadelfia, si pjesë të Shoqatës “Bijtë e Shqipes”, ata krijuan dhe Forumin e Ushtarakëve, ku mblidhen jo vetëm për festa, por edhe për gëzime e halle, mbështesin e përkrahin njëri-tjetrin, por mbajnë gjallë edhe shpirtin atdhetar e solidar që ne skënderbegasit e morëm që të vegjël në atë Shkollë të Lavdishme. E për ta mbyllur, po i kujtojmë lexuesit të gazetës “USHTRIA” se vetëm pak muaj më parë ne shkruam se Shoqata “Bijtë e Shqipes” u bë me shtëpi të re, madhështore, e mbushur nga cicërimat e vogëlushëve të Shkollës “Gjuha Jonë” e ku bashkë me shokët, dora dhe kontributi i Petritit është i dallueshëm. Ja, këto doja të tregoja për Petrit Zanin, skënderbegasin, por së pari njeriun, atdhetarin dhe shokun tonë të mrekullueshëm që nga vitet skënderbegase.



Në vitin 2005, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë që shpallte 27 janarin, si Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit në nderim të viktimave të Holokaustit. Kjo ditë përkujton miliona viktima të politikave të gjenocidit të Gjermanisë naziste, që u kryen gjatë Luftës së Dytë Botërore, si dhe përqendrohet në përpjekjet bashkëkohore për të luftuar urrejtjen dhe antisemitizmit. Gjatë Luftës së Dytë Botërore rreth gjashtë milionë njerëz u vranë, në përpjekjen sistematike naziste për shfarosjen e hebrenjve.

Në kampin Aushvic humbën jetën më shumë se një milion njerëz, të vrarë në dhomën e gazit, të rraskapitur nga kushtet e pamundura të punës, ekzekutimet e shumta, rrahjet dhe torturat nga agjentët. Viktimat ishin kryesisht hebrenj, rusë, polakë dhe rom. Kampet e vdekjes, apo siç kujtohen sot, vendet e terrorit, u çliruan më 27 janar 1945, në të cilat u gjetën ende gjallë 7 mijë të burgosur.

Në vitin 1933, Partia Kombëtare Socialiste e Punës mori pushtetin në Gjermani, me diktatorin Adolf Hitlerin si lider i saj. Nazistët kishin pasur edhe më herët mbështetje të fortë në Nuremberg dhe për arsye politike dhe më shumë praktike, zgjodhën këtë qytet për të mbajtur edhe fushatat e tyre mes viteve 1933-1938. Në shtator të 1935, ligji i Nurembergut, që shtypte të drejtat civile të hebrenjve kaloi. Një vit më vonë, në 36-ën, anëtarët e vjetër të Partisë Naziste, përfshirë këtu edhe Hitlerin dhe Rudolf Hess, që më pas u bë komandanti më jetëgjatë i kampit të përqendrimit të Aushvicit, mbërritën në Nuremberg për të parë qytetin e për të organizuar një takim atje si dhe për të zbarkuar trupat ushtarake, që mbajtën edhe një marshim gjatë Kongresit vjetor të Partisë Naziste.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, forcat pushtuese gjermane ngritën kampin Aushvic-Birkenau në jug të qytetit polak të Osvecim, rreth 70 km nga qyteti i dytë më i madh i Polonisë, Krakov. Aushvic u ngrit në maj të 1940 në ish-kazermat e vjetra ushtarake të Polonisë. Viktima e parë në këtë kamp u regjistrua në shtator të 1941-shit, pasi vdiq në një nga dhomat e gazit. Aushvic II apo Birkenau u hap në tetor të vitit 1941.4 dhoma të mëdha gazi iu shtuan kampit për 3 muaj, gjer në janar të vitit 1942.

Mes viteve 1940-1945, Aushvic u shndërrua në një kamp të mirëfilltë vdekjeje, me një kompleks kazermash, fabrikash, dhoma gazi e krematoriume, ku humbën jetën miliona njerëz, shumica prej tyre hebrenj. Grupi më i madh i viktimave, gati 75 mijë vetë, ishin polakë. Prej tyre, gati 20 mijë ishin romë.

Në fund të vitit 1941, nazistët formuluan “Zgjidhjen finale”. Vendimi për të vrarë e ekzekutuar 11 milionë hebrenj u morr gjatë

Historia e krimit që ndryshoi botën

Konferencës “Wannsee”, që u mbajt pranë Berlinit, në janar të vitit 1942, ku zyrtarët më të lartë nazistë koordinuan lëvizjet, për atë që do të shndërrohej në makinerinë më të ashpër të vrasjeve masive në histori.

Nazistët dizenuan dhe përmirësuan mekanizmin e ri të vrasjes së njerëzve. Të burgosurit u vranë me gaz, në dhomat e ndërtuara enkas për këtë qëllim e të pajisura me gaz-vdekjeprurës Zyklon B. Radha për të bërë dush ishte justifikimi më i zakonshëm për t’i marrë të burgosurit nga dhomat ku qëndronin në kamp e për t’i futur më pas në dhomat e gazit. Tonelata me flokë të prera nga kokat e të burgosurve dhe rrobat e çizmet e tyre, u gjetën më vonë, pasi kampi u çlirua.

Aushvic u çlirua, më 27 janar të vitit 1945, nga ushtria sovjetike, ushtarët e së cilës arritën të shpëtojnë e të nxjerrin të gjallë nga kampi famëkeq 7 mijë të burgosur, pasi gjermanët u tërhoqën. Kampet u shndërruan në simbolikën e holokaustit, me thujse 1,5 milionë të burgosur që humbën jetën në dhomat e gazit, në temperaturë disa gradë nën zero, nga uria, sëmundje të ndryshme, eksperimente të ndryshme mjekësore dhe nga puna e sforcuar, e rëndë dhe me orë të gjata.

Disa muaj pas çlirimit të kampit të Aushvic, 45 roje të kampit të përqendrimit dolën përpara gjykatës në Lueneburg, qyteti në veri të Gjermanisë, nën akuzën e vrasjeve në masë. Të akuzuarit ishin meshkuj e femra, që për më shumë se 5 vite shërbyen si roje por quheshin funksionarë të të burgosurve.

Të 45-të kishin punuar në kampet e Aushvic dhe Bergen-Belsen ndaj dhe gjyqi ndaj tyre u njoh si “Gjyqi Belsen”.

Joseph Kramer, i njohur gjerësisht si “Bisha e Belsen” ishte komandanti i dy kampeve, që shërbeu fillimisht në Aushvic, ku vuri diktatin e tij dhe më pas në Bergen-Belsen. Ai u arrestua pak pas çlirimit të kampit dhe u dënua me vdekje nga një gjykatë ushtarake britanike, e cila e dënoi me varje.

Irma Grese ishte një roje, krahu i djathtë e paraushtarakëve nazistë në kampet e përqendrimit të Ravensbruck dhe Aushvic. Ajo u dënua gjithashtu me vdekje dhe u ekzekutua në dhjetor të vitit 1945.

Më 20 nëntor të vitit 1945, sytë e të gjithë botës ishin fokusuar në Pallatin e Drejtësisë në Nuremberg. Vetëm 5 muaj pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, 21 ish-drejtues të lartë të partisë naziste dolën në gjyq. Mbi ta rëndonin 4 akuza: plan i përbashkët apo komplot, krime kundër paqes, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Mes tyre spikatën emrat e Hermann Goering, ish-marshall, besnik i Hitlerit dhe shef i “Luftwaffe”, një njësi ajrore që bashkërendonte veprimet me ushtrinë gjermane si dhe Rudolf Hess, zëvendësi i Hitlerit dhe komandanti më jetëgjatë që ka shërbyer në kampin e Aushvic.

Bashkë me to, përpara gjyqit doli edhe Joachim von Ribbentrop, ish-ministër i jashtëm. I destinuar për të vijuar për plot 10 muaj, gjyqi u mbajt në qytetin ku partia naziste organizonte takimet e saj të përvitshme. Gjykata e gjeti Goering fajtor për të 4 akuzat dhe e dënoi atë me vdekje. Goering helmoi veten në qeli, pak minuta përpara ekzekutimit. Edhe Von Ribbentrop u shpall fajtor për 4 akuza dhe u var bashkë me 10 të akuzuar të tjerë, më 16 tetor 1945. Rudolf Hess, zëvendësi i Hitlerit po ashtu u gjet fajtor dhe u dënua me burgim të përjetshëm, pavarësisht argumenteve të gjykatës sovjetike se ai duhej dënua me vdekje, njësoj si të tjerët.

“Privilegji i çeljes së gjyqit të parë në histori për krime kundër paqes në botë, të vendos përpara një përgjegjësie të jashtëzakonshme. Veprimet e gabuara që kërkojmë të dënojmë dhe ndëshkojmë kaq qenë aq të përllogaritura, aq të këqija dhe aq shkatërruese, sa civilizimi s’do të mund të tolerojë që ato të injorohen, sepse nuk duhet të përsëriten kurrë më”, shprehej asokohe gjykatësi John Jackson.

Ajo çka mbetet është thjesht përkujtimi, rikthimi në kohë për të mësuar të vërtetat e asaj çfarë ka ndodhur, përmes historive njerëzore, edhe të atyre që i mbijetuan kampit. Sot ai është shndërruar në një muze, i frikshëm për nga ndjenja që përcjell, edhe pse më shumë se 2 milionë njerëz e vizitojnë atë çdo vit. Vizita atje nuk është një mësim për historinë por një moment



reflektimi mbi përgjegjësinë. I gjithë kampi përbëhej nga një kompleks ndërtesash, ish-godina të vjetra në shërbim të ushtrisë polake, ndarë në vitin 1940 në 40 ndërtesa përqendrimi dhe asgjësimi, siç quheshin nga nazistët. Më i madhi ishte Aushvic, më pas Birkenau, të cili iu shtuan edhe dhomat e gazit si dhe një kamp më vete pune, për të krijuar aty agjentët kimikë. Të burgosurit në kamp torturoheshin nga rojet, rriheshin dhe më pas ekzekutoheshin për motive të ndryshme.

Më famëkeqi ishte Blloku 11, atje ku në gusht të 41-shit, nisën edhe ekzekutimet në dhomën e gazit. 802 të burgosur tentuan të arratiseshin,144 ia dolën me sukses. Vetëm 789 vetë, pjesë e stafit që kujdesej për kampin, dolën përpara gjyqit pas çlirimit të tij, gati 15% e totalit. Në dekadat pas luftës, të mbijetuarit e Aushvic si Primo Levi, Viktor Frankl dhe Elie Wiesel shkruan kujtimet për eksperiencën e tyre dhe kampi u bë simbol dominues i Holokaustit. Në vitin 1947, Polonia vendosi krijimin e Muzeut Shtetëror të Aushvic-Birkenau dhe në vitin 1979 ai u bë pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Dëshmitë e të mbijetuarve

Tatyana Fomina ishte një vajzë e vogël në atë kohë por dëshmitare e gjithçkaje ndodhi në Aushvic. Bashkë me familjen, Tatyana jetonte në një fshat të Bjellorusisë ndërsa pa babanë e saj, të digjej i gjallë nga trupat gjermane në vitin 1943. Në tetor të atij viti, Tatyana dhe familja e saj, ajo që i shpëtoi zjarrit, u dërgua në kampin famëkeq. Rrëfimi është i jashtëzakonshëm dhe ajo mban mend çdo detaj, të çdo dite të kaluar në Aushvic.

“Babai im më mbështolli me lëkurë dhe më dorëzoi tek nëna. Ajo ish ulur bashkë me vëllezërit dhe motrat, ishim 4. Më dorëzoi tek nëna dhe tha: Agasha, të lutem, kujdesu për më të voglën. Ajo ishte hera e fundit që unë e pashë tim atë”, kujton ajo. “Ata na shtynë pas 500 metra, në hyrje të pyllit dhe po rrinim pranë njëri-tjetrit dhe shihnim të frikësuar sesi gjermanët derdhën benzinë e vajguri gjithandej dhe më pas i vunë flakën. Ne rrinim e shihnim sesi të dashurit tanë u dogjën të gjallë. Nazistët na merrnin ne fëmijëve gjak, na merrnin shumë gjak, sidomos djemve që ishim më të fortë, aq sa ata më pas humbnin ndjenjat. Nëse kalonin në atë gjendje, direkt i dërgonin në krematorium”.

Tatyana tregon fotot e fëmijërisë... “Nuk kishim fare fuqi, nuk na lejonin të flisnim as në rusisht apo bjellorusisht, lejohej që të flisnim vetëm në gjuhë polake apo gjermanisht ne nuk dinim. Nëse rojet na dëgjonim që flisnim me njëri-tjetrin në gjuhën amtare, na ndëshkonin. Në fund të kazermave, kishte një tualet të madh, ku çdokush mund të zhytej brenda, të mbytej me forcë e gjithçka tjetër. Ne kishim frikë nga gjithçka, ne donim të jetonim. Mendonim që së paku nëna jonë të ishte gjallë, sepse babain e dinim tashmë që kishte vdekur.

Shpresonim që të shpëtonim”.

Tatyana atëherë ishte vetëm 8 vjeçe, nuk e mban mend ditën e çlirimit por kujton që më pas e dërguan në një jetimore në Moskë, së pari për të marrë veten fizikisht e mendërisht, derisa nisi shkollën në vitin 1946.

Në kërkim të të afërmeve

Një fotografi e vjetër dhe teknologjia më e fundit, ajo e njohjes automatike të fytyrës, mund të ndihmojë sot 2 vëllezër izraelitë të bien në gjurmët e vëllait tjetër, që i shpëtoi holokaustit, 75 vite më parë. Në kërkim të një përgjigjeje nga e shkuara, Eli dhe Saul Lieberman janë rikthyer në qendrën e kërkimit në Izrael, ku teknologjia sot ofron mundësinë e përshtatjes së fotografive të të mbijetuarve me fotot e vjetra të kohës së Luftës së Dytë Botërore, në databazën me mijëra foto, të realizuara në atë kohë nga vetë ushtarët gjermanë. Në foto shfaqen vetë ushtarët gjermanë si dhe njerëzit në fshatrat apo qytetet me popullsi hebreje. “Kemi shumë pak informacion rreth vëllait tim, dimë shumë shumë pak. Gjithçka di i kam mësuar nga burime të huaja. Ndërsa për babain, nuk mësuam kurrë asgjë”, tha Saul Lieberman, i mbijetuar.

Qendra Përkujtimore e Holokaustit “Shem Olam” ka lançuar projektin e quajtur “Ballë për ballë”, ku përmes rrjeteve sociale i bën thirrje njerëzve të dërgojnë foto për njohjen e përshtatjen e fytyrës përmes skanimeve.

Vetë Eli dhe Saul janë të mbijetuar të kampit të Aushvic. Përmes fotove të vjetra të viteve 45-50, ata synojnë të gjejnë të vëllain e të mësojnë për historinë e familjes së tyre.

“Ballë për ballë” është projekti i parë që synon të krijojë një përballje, një përafrim të realitetit sot dhe historisë së 75 viteve më parë, pas holokaustit. Ai nuk ishte vetëm realiteti i 6 milionë hebrenjve, që humbën jetën. Është edhe realiteti e historia e atyre që i mbijetuan atyre torturave dhe atij kampi vdekjeprurës e të cilët prej asaj kohe nuk kanë asnjë lidhje me të shkuarën”, Avraham Krieger, drejtor i qendrës përkujtimore “Shem Olam”.

Deri më tani, qendra e kërkimeve Shem Olam, ka marrë mijëra foto nga publiku por vetëm disa prej tyre kanë përkuar me njerëzit që kërkojnë të afërmit. “Po flasim për disa teknologji të avancuara, të cilat ne i përdorim. Gjithçka ofrohet falas për publikun, në mënyrë që çdokush të mund të gjejë e të krijojë kontakte me familjarët e tyre, të zhdukur pas holokaustit”, Assaf Fassy, menaxher i shërbimeve digjitale.

“Mendoj se nuk mund të vazhdojmë përjetësisht me idenë se nuk dimë asgjë. Jetojmë në këtë botë, ku s’mund të sigurojmë më asnjë dokument tonin. Jetojmë në një botë ku vajza ime, të gjithë miqtë e

saj, e dinë historinë e tyre. Kjo ka sens. Njerëzit duan të dinë nga vijnë”, thotë Saul Lieberman, i mbijetuar.

“Mjaftonte një tatuazh që të mbetet në trup e në lëkurë për gjithnjë. Ai ishte emri nga dita kur shkelje në Aushvic. Një numër që të shoqëron përjetë e që është numri i të burgosurit e që përkon me ditën kur mbërrije në kamp”... Avraham Harshalom mbërriti në Aushvic në vitin 1943. E mban mend shumë mirë numrin e tij.

“Në Aushvic askush nuk dinte emra. Oficerët gjermanë, kur flisnin me ty, të thërrisnin në emër. Është histori e gjatë. Por 20 vitet e para pas holokaustit, të gjithë ne të mbijetuarit, e kryesisht të burgosurit e Aushvic, nuk flisnim fare, as me median e as me njëri-tjetrin. Ne nuk tregojmë, sepse njerëzit nuk na besojnë por sepse kur na dëgjojnë, thonë: si ka mundësi që nga gjithë ai ferr, ju mbijetuat? Dhe historia e mbijetesës është vërtet histori e komplikuar. Çdokush nga ne, ka historinë e tij se si mbijetoi”, thotë ai.

Harshalom është një nga 200 mijë të mbijetuarit e Holokaustit, që sot jeton në Izrael. Ai thotë se çdo vit që kalon, aq më të pamundur e ka të sigurojë, edhe për veten e tij, prova të krimeve të frikshme të kryera nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku 6 milionë hebrenjtë humbën jetën. Harshalom kish lindur në një fshat të vogël të Polonisë dhe ishte 17 vjeç kur mbërriti në kamp. Menjëherë u përzgjedh nga oficerët si krah pune dhe kjo duket se i shpëtoi jetën. Ata që nuk pranonin punën, dërgoheshin menjëherë në dhomat e gazit: dënim me vdekje. Në Aushvic, Avraham humbi nënën dhe vëllain.

“Njerëzit atje ndaluan së menduari normalisht. Truri nuk funksiononte më. Të gjithë ne mendonim vetëm sesi të siguronim veç një copë bukë dhe sesi të mos vriteshim nga gjermanët.

Artemis Meron, nga një komunitet hebre në Greqi, ishte 15 vjeç në vitin 1944, kur u dërgua në Aushvic me nënën dhe vëllain 9 vjeç. Ajo tregon se shumë njerëz humbën jetën që rrugës, pa mbërritur në kamp.

“Ne nuk dinim ku po shkonim. Donim vetëm të ishim bashkë. U përqaftuan. Mendoj se ngjaja më e madhe në moshë për shkak të një palltoje me pelush që nëna më kish hedhur krahëve, sepse jashtë binte borë. Gjermanët menduam se jam e rritur dhe më goditën, me hodhën në tokë dhe nënën e vëllain i futën në një makinë, e mbyllën derën dhe u larguan. Nuk pata rastin as t’i them lamtumirë, arrita të thosha nën zë vetëm mirupafshim”, Artemis Meron, e mbijetuar. “E keqja më e madhe ishte se ne nuk dinim asgjë, nuk kishim kë të pyesnim se çfarë ndodhi me familjarët tanë. Më pas mësuam të vërtetën. Pastaj nga larg dallonim tymin. Mendonim se gatuanin në kuzhinë, për të gjithë ata që mbaheshin të burgosur. Në atë kohë kurrë nuk e mendonim se bëhej fjalë për krematorium. Pastaj thosha me vete: për çfarë të jetoj, edhe nëse lufta mbaron?”. “Sot mendoj, si mund të ndodhë diçka e tillë në shekullin e 20 dhe askush, asnjë vend nuk mund të ndihmojë, thjesht sepse gjermanët vendosën të shfarosin çdo hebre në botë? Pyes, sepse nuk kam marrë asnjë ndihmë nga askush, as nga kryqi i kuq, i cili nuk u përfshi në këtë histori. Jam shumë e nevrikosur. Ndihehem shumë keq për këtë gjë. Shoh fëmijët e mi, nipërit dhe mbesat dhe ky është i vetmi ngushëllim që kam”.

Vera Grossman Kriegel, sot 81-vjeçe, është një tjetër e mbijetuar e kampit të vdekjes. Në moshën 6-vjeçare, Vera dhe motra e saj binjake iu nënshtruan eksperimenteve pseudo-mjekësore të mjekut Josef Mengele, i cili i përdorte të burgosurit e Aushvic si subjekte kërkimore, duke i dhënë atij emrin “Engjëlli i vdekjes”. Vera dhe motra e saj ishin ndër të paktët fëmijë që i mbijetuan dashakeqësisë dhe makabriteteve të tij. Ajo tregon se mbahej nga doktori në një kafaz, krejt e zhveshur dhe i bëheshin injeksione direkt e në shtyllën kurrizore. Ndërsa për muaj të tërë ka parë bashkëmoshatarë të saj, të rrihen barbarisht e të ndërrojnë jetë. “Zoti donte që unë të mbeteshja gjallë dhe të tregoja historinë time”, kujton ajo. “Në fund të kazermave, kishte një kafaz, tamam si kafaz kafshësh, ku vendoseshin majmunë, lepuj, nuk e di, kafshë të ndryshme. Të hiqnin rrobat, ti ulesh atje. Unë dhe motra ime bashkë me nënën, bashkë me ne edhe dy binjakë të tjerë, ndoshta 10 vjeç. Për rreth 2 javë, pa pushim, Mengele dhe ekipi i tij, nga kanë bërë gjithë kohës injeksione në shtyllën kurrizore”.

“Ato gjilpëra na dhanë simptoma të tmerrshme, të vjella dhe temperaturë të lartë. Dhimbja ishte e jashtëzakonshme. Dhe ishte e ndaluar rreptësisht të qaje. Kush qante, rrihej. Ai më kapi nga jaka e palltos, më goditi dhe më hodhi në fund të bllokut, në fund të kazermave. Goditja ishte e fortë. Me vete mendoja se erdhi fundi. Por ai nuk do të shohë kurrë një pikë loti në sytë e mi. nuk ka shanse. Nuk do më thyejë. E mendoja si çdo njeri tjetër, me dy duar, një fytyrë, dy veshë. Por përse po ma bën këtë gjë? I mbaja sytë gjatë gjithë kohës të ngulura tek sytë e tij. Mengele ishte djalli vetë, por kur më shihte në sy, ulte sytë”.

Krime që historia do t’i dënojë gjithmonë. Horrori çnjerëzor është realiteti që të zgjon nga ëndrra e një makthi të frikshëm.

Cila është puna e ëndrrave?

Një hartë magjepsëse e ripunuar ka zbuluar punët më të njohura në mbarë botën - dhe të qenit pilot është puna e ëndrrave numër një në botë në vitin 2025.

Në hartë, vendet janë koduar me ngjyra për të treguar punët për të cilat banorët e tyre duan më shumë informacion me synimin për të filluar atë karrierë.

Shprehja 'si të jesh pilot' është kërkuar 432,360 herë në Google gjatë vitit 2024, me krye të kërkimit në Egjipt, Republikën Çeke dhe Sllovaki.

Sipas hulumtimit, nga ofruesi i shërbimeve financiare Remitly, puna e dytë më e popullarizuar në planet është avokati, me 393,380 kërkime në mbarë botën. Karriera ligjore është kërkimi kryesor në shumë vende, duke përfshirë Francën, Brazilin, Kinën dhe Spanjën.

Të qenit oficer policie vjen e treta (272,730) në mbarë botën dhe është karriera e ëndrrave nr.1 si në Korenë e Jugut ashtu edhe në Poloni.

Në Angli, Skoci dhe Irlandën e Veriut, 'si të jesh një YouTuber' (i 13-ti në mbarë botën, 171,840), është kërkimi më i popullarizuar i karrierës dhe kryeson gjithashtu listën në Singapor, Indonezi dhe Fixhi.

Stjuardesa vjen në krye në SHBA (e 17-ta në mbarë botën, 154,810) dhe është gjithashtu karriera më e dëshirueshme në Xhamajka dhe Barbados.

Punët në sektorin e shëndetësisë janë gjithashtu të njohura me farmacistë (e 4-ti në mbarë botën/272,630/më e lartë në Japoni) dhe infermierë (e pesta në mbarë botën, 248,720) duke përmbyllur pesë karrierat më të mira të ëndrrave.

Fizioterapia vjen e gjashta në renditje (244,050), mamia vjen e shtata (227,010) dhe prokurori i teti (220,870, në krye në Turqi).


Pjesa tjetër e top 10-ës përbëhet nga aktori (i nënti/199,150/ kryeson në Austri) dhe gjyqtari (i dhjeti, 198,450).

Ndërsa nuk arrin të bëjë 20 kërkimet më të mira globale për punë, 'si të jesh DJ' (109,650) është kërkimi numër 1 i karrierës në Australi, Kanada, Irlandë, Indi dhe Zelandën e Re.

Në Evropë, si Italia ashtu edhe Bullgaria po kërkojnë punë jashtë 20 top 20-sheve botërore, me trajnerin e fitnesit (70,180 në mbarë botën) që kryeson listën e karrierave të ëndrrave në Itali dhe drejtuesit e taksisë në Bullgari.

Profesori (i 12-ti në mbarë botën, 175,420) kryeson listën në Portugali, Belgjikë dhe Gjermani, ndërsa Uells mbulon trendin e YouTuber-it në MB me paramedikët (i 20-ti në mbarë botën, 136,820) që renditet si kërkimi kryesor i tij.

Në Amerikën Qendrore, avokati (i dyti në mbarë botën, 393,380) është tepër i popullarizuar dhe karriera më e kërkuar në Meksikë, Guatemalë, Honduras, El Salvador, Nikaragua, Kosta



Rika, Panama dhe Republikën Domenikane.

Avokati është gjithashtu i popullarizuar në Amerikën e Jugut, por 'si të jesh aktore' është më popullorja në Argentinë (97,700) ndërsa zjarrfikësi është në krye në Kili (i 16-ti në mbarë botën, 155,120).

'Si të jesh krijues përmbytës' (content creator) (52,360) është një zgjedhje kryesore në Afrikë, duke kryesuar listën në Nigeri, Kamerun dhe Tanzani, ndërkohë që shfaqen edhe karriera të tjera krijuese si blogger dhe autor.

Edhe pse sipërmarrësi nuk arrin të hyjë në top 20 në mbarë botën, është zgjedhja më e popullarizuar në Cote D'Ivoire, Angola, Republika e Kongos, Kongo, Madagaskar, Gabon, Guinea dhe Senegal.

Në Azi, 'si të jesh mjek' (i 11-ti në mbarë botën, 192,280) është kërkimi kryesor në Myanmar dhe Filipine, ndërsa avokati është zgjedhja më e popullarizuar në Lindjen e Mesme.

Jordania përkufizon prirjen ligjore në rajon me 'si të jesh futbollist' (95,950), karriera nr.1 e ëndrrave për banorët.

Banorët e Papua-s, e Guinesë së Re, do të donin më shumë të ishin shkrimtarë krijues, duke u dalluar nga pjesa tjetër e Oqeanisë,

ku DJ dhe avokati janë zgjedhjet kryesore.

Ryan Riley, nënkryetar i marketingut për EMEA dhe APAC në Remitly, thotë: "Është magjepsëse të shohësh karriera kaq të larmishme të paraqitura ndër punët e ëndrrave më të kërkuara në botë".

"Ne po shohim një trend ku punët e ëndrrave të botës po bëhen më korporative dhe të fokusuara në pagat e larta mbi qëllimet e tjera të karrierës, veçanërisht të parë me rritjen e profesioneve ligjore.

"Interesi në rritje për karrierat e lidhura me shëndetin është veçanërisht frymëzues dhe mund të jetë ende një ndikim i pandemisë, duke i bërë njerëzit të kërkojnë role që u shërbejnë komuniteteve të tyre.

Për shumë njerëz, ndjekja e një karriere të ëndrrave mund të nënkuptojë lëvizjen jashtë vendit ku ka më shumë vende pune. Nëse ky është qëllimi, unë rekomandoj shumë kërkime dhe të bëni një plan tre-vjeçar përpara se të bëni hapin.

"Kjo do t'ju lejojë të planifikoni më mirë financat, të vlerësoni rritjen e karrierës dhe ju ndihmon për të lehtësuar stresin kur lëvizni jashtë vendit".

20 punët më të preferuara në të gjithë botën në 2025

sipas vëllimit të kërkimit global

1. Pilot - 432,360 kërkime në Google në 2024

2. Avokat - 393 380

3. Oficer policie - 272.730

4. Farmacist - 272 630

5. Infermiere - 248 720

6. Fizioterapist - 244.050

7. Mami - 227.010

8. Prokuror - 220 870

9. Aktor - 199, 150

10. Gjyqtar - 198 450

11. Doktor - 192.280

12. Profesor - 175.420

13. YouTuber - 171,840

14. Dietolog - 170.920

15. Psikolog - 160.270


16. Zjarrfikës - 155 120

17. Stjuardesa - 154.810

18. Agjent imobiliar - 153,640

19. Psikiatër - 152.290

20. Ndihmësmjek - 136 820



Gara globale për AI-në

Ndërsa BE-ja po zbaton rregulla gjithëpërfshirëse për të garantuar sigurinë dhe përgjegjshmërinë e përdoruesve, Presidenti i SHBA Donald Trump po heq mbrojtjen dhe po i jep më shumë ndikim industrisë së teknologjisë.

Ndërsa inteligjenca artificiale riformëson industritë dhe shoqëritë, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian janë gjithnjë e më shumë në mosmarrëveshje mbi mënyrën se si ta rregullojnë atë.

Rritja e shpejtë e AI-së po u mundëson kompjuterëve të kryejnë në mënyrë autonome detyra që dikur vareshin nga inteligjenca njerëzore. Kjo hap mundësi të mëdha nga mjekësia e personalizuar për të adresuar sfidat globale si kriza klimatike. Por ajo gjithashtu paraqet rreziqe të konsiderueshme, nga zhvendosja e vendeve të punës tek teknologjitë e njëanshme deri tek abuzimi i mundshëm në fusha të tilla si mbikëqyrja.

Ndërsa BE-ja po nxjerr një rregullore gjithëpërfshirëse të AI-së për të garantuar sigurinë dhe llogaridhënien e përdoruesve, Shtetet e Bashkuara nën Presidentin Donald Trump po lëvizin në drejtim të kundërt, duke liruar kufizimet dhe duke fuqizuar figurat e industrisë së teknologjisë për të ndikuar në politikë.

“Në SHBA, ne po shohim një zhvendosje të qartë nga vënia e theksit në sigurinë e përdoruesit”, - tha Lisa Soder, një studiuese e lartë e politikave në institutin e teknologjisë së informacionit “Interface” në Berlin.

Trump po ndryshon gjithnjë e më shumë qasjen e vendit ndaj rregullimit të AI-së për t’i dhënë përparësi sigurisë kombëtare dhe interesave të industrisë, tha ajo për DW: “Inteligjenca artificiale e parë në Amerikë është shumë e madhe tani”.

Ndikimi i Big Tech

Që nga dita e tij e parë në detyrë, u bë e qartë se sa shumë ndikim Trump dhe administrata e tij e re janë të gatshëm t’i japin industrisë se si rregullohet AI.

Inaugurimi i tij si presidenti i 47-të u ndoq nga miliarderë të teknologjisë, duke përfshirë CEO të Tesla dhe SpaceX, Elon Musk, CEO i OpenAI, Sam Altman dhe CEO i Meta, Mark Zuckerberg, të cilët ishin ulur dukshëm në rreshtin e dytë direkt pas familjes së Trump. Po atë ditë, Trump anuloi një urdhër ekzekutiv të lëshuar nga paraardhësi i tij, Joe Biden, duke çmontuar disa mbrojtje dhe iniciativa të AI-së të vendosura gjatë administratës së Biden.

Në ditët në vijim, Trump ftoi Altman, si dhe CEO të kompanive të teknologjisë “SoftBank” dhe “Oracle”, në Shtëpinë e Bardhë për të shpallur atë që ai e përshkroi si “projektin më të madh të infrastrukturës së AI-së në histori”. Gjatë katër viteve të ardhshme, megaprojekti, i quajtur “Stargate”, do të investojë deri në 500 miliardë dollarë në infrastrukturën e AI-së, duke përfshirë qendrat e të dhënave. “Gjithçka po ndodh këtu në Amerikë”, - u tha Trump gazetarëve.

Ai gjithashtu nënshkroi një urdhër ekzekutiv për të zhvilluar një “Plan Veprimi për AI” brenda 180 ditëve. Plani synon “të mbështesë dhe përmirësojë dominimin e Amerikës në AI”.

Ndërsa detajet e kësaj politike mbeten të paqarta, pritët gjerësisht t’u japë gjigantëve të teknologjisë liri të konsiderueshme për të zhvilluar teknologjinë e re të AI-së. Politika gjithashtu ka të ngjarë të reduktojë kërkesat për kompanitë për të zbutur rreziqet ndërsa zhvillojnë aplikacione të përditshme.

A do të qëndrojë BE besnike ndaj qasjes së saj “siguria së pari”?

Kjo qasje e thjeshtë ndaj rregullimit të AI-së qëndron në kontrast të plotë me mjedisin rregullator në anën tjetër të Atlantikut.

Atje, Akti historik i BE-së për Inteligjencën Artificiale u bë ligj verën e kaluar. Qëllimi i tij është të mbrojë qytetarët e BE-së nga dëmet e mundshme të AI-së pa mbytur inovacionin. Për të arritur këtë akt balancues, Akti i AI-së vendos një sërë rregullash dhe kërkesash për sistemet e AI-së, nga minimale në të larta, në varësi të rrezikut që ato paraqesin për të drejtat themelore të përdoruesve.


Por ndërsa përkrahësit e rregullave strikte duartrokasën BE-në për këtë qasje, duke e quajtur të nevojshme mbrojtjen e përdoruesve, kritikët thonë se kjo do t’i vendosë kompanitë evropiane në disavantazh ndaj konkurrentëve të tyre jashtë shtetit.

Në të njëjtën kohë, ndërsa autoritetet në Bruksel dhe vendet anëtare ngritën zyra dhe ekipe stafi për të zbatuar rregullat, një debat po shpaloset mbi mënyrën se si rregullatorët do të interpretojnë ligjet e reja.

“Në BE, ne po shohim gjithashtu një ndryshim në ndjenja dhe shumë pasiguri rreth asaj që është me të vërtetë e realizueshme dhe sa ambicioze mund të jetë BE me rregullat e saj - për shembull, çfarë lloj informacioni mund të kërkojnë nga kompanitë”, - tha Soder.

Gara globale për AI-në

Ekspertët presin që presidenca e Trump të ketë një ndikim të qëndrueshëm në garën globale për AI-në: konkurrenca



ndërkombëtare midis kombeve dhe kompanive për të zhvilluar dhe vendosur teknologjinë e fundit të AI-së që do t’u japë atyre avantazhe ekonomike, ushtarake dhe strategjike.

Deri më tani, Shtetet e Bashkuara janë kryesuesi i qartë, duke dominuar si kërkimin dhe investimet e AI-së, si shtëpia e gjigantëve të teknologjisë si Google, Meta, Apple dhe OpenAI. Por Kina dhe kompanitë e saj, të renditura të dyta në zhvillimin e AI-së, kanë bërë përparim të shpejtë.

Vitet e fundit, përpjekjet për të zhvilluar rregulla ndërkombëtare detyruese dhe parrake për teknologjinë AI, kanë qenë kryesisht të pasuksesshme. Tani, me Trump në Shtëpinë e Bardhë, ato duken më pak të mundshme se kurrë.

Edhe angazhimet vullnetare për zhvillimin dhe përdorimin e sigurt të AI-së që kanë bërë në të kaluarën shumë kompani të mëdha të teknologjisë tani duken në ajër, tha Soder. Kur shumë CEO të takohen me liderët botërorë në Paris më 10 dhe 11 shkurt për Samitin e Veprimit të Inteligjencës Artificiale (AI) të organizuar nga qeveria franceze, do të jetë interesante të shihet se sa shumë i qëndrojnë ata, shtoi ajo.

“Në të kaluarën, kompanitë kanë premtuar se do të bëjnë shumë punë në emër të sigurisë dhe besueshmërisë”, - tha ajo. “Tani që situata gjeopolitike ka ndryshuar, ky samit do të jetë një test vërtet i rëndësishëm për të parë nëse ata do të vazhdojnë ta bëjnë këtë”.



DeepSeek “mposht” ChatGPT

Lañimi i modeleve më të fundit të inteligjencës artificiale nga ana e startup-it kinez “DeepSeek”, për të cilat thotë se janë në të njëjtin nivel ose më të mirë se modelet kryesore të industrisë në Shtetet e Bashkuara me një fraksion të kostos, po kërcënon të shqetësojë botën e teknologjisë.

Kompania ka tërhequr vëmendjen në qarqet globale të AI-së pasi shkroi në një artikull muajin e kaluar se trajnimi i DeepSeek-V3 kërkonte më pak se 6 milionë dollarë fuqi llogaritëse nga çipat Nvidia H800.

Asistenti AI i DeepSeek, i mundësuar nga DeepSeek-V3, ka tejkaluar rivalin ChatGPT për t’u bërë aplikacioni falas më i vlerësuar në dispozicion në App Store të Apple në Shtetet e Bashkuara. Në një deklaratë të tij si president i ri SHBA-ve, Donald Trump është shprehur se: “Lëshimi i DeepSeek, AI nga

një kompani kineze duhet të jetë një thirrje zgjimi për industritë tona që ne duhet të jemi të përqendruar fort për të konkurruar e për të fituar”.

Kjo ka ngritur dyshime në lidhje me arsyetimin pas vendimit të disa kompanive të teknologjisë amerikane për të premtuar miliarda dollarë investime në AI dhe aksionet e disa lojtarëve të mëdhenj të teknologjisë, përfshirë Nvidia, janë goditur. Më poshtë janë disa fakte rreth kompanisë që trondit sektorin e AI-së në mbarë botën.

Pse DeepSeek shkakton shqetësime?

Lëshimi i ChatGPT i OpenAI në fund të vitit 2022 shkaktoi një përleshje midis firmave kineze të teknologjisë, të cilat nxituan të krijonin chatbot-et e tyre të mundësuar nga inteligjenca artificiale.

Por pasi publikimi i ekuivalentit të parë kinez ChatGPT, i bërë nga gjigandi i motorëve të kërkimit Baidu (9888.HK), hapi skedën e re, pati një zhgënjim të gjerë në Kinë për hendekun në aftësitë e AI-së midis firmave amerikane dhe kineze.

Cilësia dhe efikasiteti i kostos së modeleve të DeepSeek e kanë kthyer këtë tregim në kokë. Dy modelet që janë lavdëruar nga drejtuesit e Silicon Valley dhe inxhinierët e kompanive të teknologjisë amerikane, DeepSeek-V3 dhe DeepSeek-R1, janë në të njëjtin nivel me modelet më të avancuara të OpenAI dhe Meta, ka thënë startup-i kinez.

Ato janë gjithashtu më të lira për t’u përdorur. DeepSeek-R1, i lëshuar javën e kaluar, është 20 deri në 50 herë më i lirë për t’u përdorur se modeli OpenAI o1, në varësi të detyrës, sipas një postimi në llogarinë zyrtare të DeepSeek në WeChat. Por disa kanë shprehur publikisht skepticizëm për historinë e suksesit të DeepSeek.

Shefi ekzekutiv i Scale AI, Alexandr Wang tha gjatë një interviste me CNBC, pa dhënë prova, se DeepSeek ka 50,000 çipa Nvidia H100, të cilat ai pretendoi se nuk do të zbuloheshin sepse kjo do të shkelte kontrollat e eksportit të Uashingtonit që ndalojnë çipat e tillë të avancuar të AI të shiten në kompanitë kineze. DeepSeek nuk iu përgjigj menjëherë një kërkesë për koment mbi akuzën.

Analistët e Bernstein theksuan të hënën në një shënim kërkimor se kostot totale të trajnimit të DeepSeek për modelin e tij V3 ishin të panjohura, por ishin shumë më të larta se 5.58 milionë dollarët që startup tha se përdorëshin për fuqinë kompjuterike. Analistët thanë gjithashtu se kostot e trajnimit të modelit po aq të mirënjohur R1 nuk u zbuluan.

Kush është prapa DeepSeek?

DeepSeek është një startup me bazë në Hangzhou, aksioneri kontrollues i të cilit është Liang Wenfeng, bashkëthemelues i fondit mbrojtës sasiar High-Flyer, bazuar në të dhënat e korporatave kineze.

Fondi i Liang njoftoi në mars 2023 në llogarinë e tij zyrtare WeChat se po “fillonte përsëri”, duke shkuar përtej tregtisë për të përqendruar burimet në krijimin e një “grupi të ri dhe të pavarur kërkimor, për të eksploruar thelbin e AGI” (Inteligjencës së Përgjithshme Artificiale). DeepSeek u krijua më vonë atë vit.

Krijuesit e ChatGPT OpenAI e përcaktojnë AGI si sisteme autonome që tejkalojnë njerëzit në detyrat më të vlefshme ekonomiksht. Është e paqartë se sa ka investuar High-Flyer në DeepSeek.

SESIONI DEEP DIVE, GRATË NË USHTRI

Thyerja e barrierave dhe ndërtimi i një lidërshipi të ekuilibruar

Zyra e Këshilltarit Gjinator të Stafit Ushtarak Ndërkombëtar (IMS) të NATO-s (GENAD) priti në Bruksel, një sesion të thellë mbi Gratë në Ushtri: Thyerja e Barrierave dhe Ndërtimi i Lidërshipt të Balancuar. Diskutimi mbledhi së bashku udhëheqëse ushtarake femra nga Kombet Partnere për të ndarë përvojën e tyre personale në avancimin e karrierës së tyre ushtarake.

Vështrimet u dhanë nga gjenerale Lisa Ferris, Këshilltarja e Mbrojtjes e Zelandës së Re në Mbretërinë e Bashkuar dhe Përfaqësuese e Lartë Ushtarak i Zelandës së Re në NATO dhe BE; Gjenerale Lara Troy, komandante e Kolegjit Australian të Luftës; dhe Nënkolonele Nour Al Masarweh, Oficere e Koordinimit dhe Bashkëpunimit të Granteve Ndërkombëtare në Drejtorinë e Planifikimit dhe Organizimit, Forcat e Armatosura Jordaneze.

Gjenerale Ferris hapi seancën, duke reflektuar mbi evolucionin e organizatës që kur Zelanda e Re hapi të gjitha rolet për gratë në vitin 1987, duke pranuar përparimet ndërsa theksoi se mbetet shumë për të bërë. Ajo theksoi paragjykimet e nënkuptuara në mundësitë e karrierës dhe vendosjes dhe sesi paragjykimi i pavarësisht mund të mbështesë sistemet e rrënjësura brenda një kulture dhe kuadri organizativ të dominuar nga meshkujt. Gjenerale Ferris preku programin “Wāhine Toa” të Forcave të Mbrojtjes së Zelandës së Re, i cili ka prezantuar masa të ndryshme praktike, duke përfshirë ofrimin e produkteve menstruale në të gjitha bazat dhe zbatimin e trajnimeve të etikës seksuale. Ajo vuri në dukje se këto ndryshime të vogla por me ndikim pasqyrojnë një përpjekje më të gjerë për të riformuar kulturën organizative.

Gjenerale Troy theksoi rëndësinë e ndërtimit të rrjeteve mbështetëse për fuqizimin e grave në ushtri, gjithashtu përmes iniciativave të tilla si “Bashkimi i Grave Halifax” dhe programeve të brendshme në Kolegjin Australian të Luftës, të cilat kanë krijuar hapësira për gratë për të ndarë përvojat, për të festuar sukseset dhe nxisin elasticitetin.

Gjenerale Troy trajtoi gjithashtu paragjykimet strukturore që pengojnë avancimin e grave. Ajo vuri në dukje se rolet drejtuese shpesh vijnë me nocione të paracaktuara se kush është “e përshtatshme” për punën, të përjetësuar nga stereotipet gjinore. Ajo mbrojti rivlerësimin e parakushteve të roleve për t’u fokusuar në talentin dhe jo te etiketat. Zbërthimi i këtyre paragjyqimeve kërkon introspeksion dhe këmbëngulje. Sipas gjenerales Troy, gratë duhet të bëjnë të njohura aspiratat e tyre, të ndjekin trajnimet e nevojshme dhe të pozicionohen si zgjedhja



e duhur për mundësitë e lidërshipt. Stereotipet rreth sjelljes femërore kundrejt asaj mashkullore komplikojnë më tej udhëtimet e lidërshipt të grave, gjë që duhet sfiduar nga një qasje e tërë shoqërisë. Mjetet si profilizimi i personalitetit mund të ndihmojnë në zbulimin e të përbashkëtave midis gjinive, duke thyer këto stereotipe dhe duke nxitur mirëkuptimin e ndërsjellë.

Nënkolonelja Nour diskutoi përparimet dhe sfidat me të cilat përballen gratë në Forcat e Armatosura jordaneze, duke theksuar momentet kryesore në avancimin e tyre në fusha të ndryshme shërbimi. Ajo shpjegoi se balancimi i përgjegjësiwe familjare me një karrierë ushtarake mbetet një pengesë e rëndësishme, por Forcat e Armatosura jordaneze kanë ndërmarrë hapa për ta adresuar këtë

nëpërmjet programeve të zhvillimit të lidërshipt dhe nismave për ndarjen e njohurive. Sesioni Deep Dive eksploroj më tej qasjet për të thyer barrierat për gratë në ushtri. Kjo përfshin çmontimin e stereotipeve të rrënjësura, sigurimin e mundësive të barabarta të karrierës dhe promovimin e aleatizmit në mjediset e dominuara nga meshkujt. Sesioni theksoi se si NATO do të vazhdojë të promovojë pjesëmarrjen e plotë, të barabartë, të sigurt dhe kuptimplotë të grave në paqe dhe siguri, jo vetëm si një hap drejt barazisë, por si një element kritik i ndërtimit të forcave të armatosura më të forta dhe më elastike. Kjo është në përputhje me politikën e saj për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe thekson kontributet domethënëse të grave ushtarake në të gjithë Aleancën.

Rezervat e NATO-s janë “të domosdoshme”, thotë Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s



Mbledhja vjetore Plenare për Rezervat mbledhi së bashku katër grupe: Komiteti i NATO-s për Rezervat (NCR), Konfederatat e Ndërlidhura të Oficerëve Rezervë (CIOR), Konfederata e Ndërlidhura të Oficerëve të Rezervës Mjekësore (CIOMR) dhe Konfederatat e Ndërlidhura të Jo-Rezervës. Oficerët e Komisionuar (CISOR). Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admirali Cavo Dragone u foli atyre se si Forcat Rezervë janë jetike për Aleancën.

Ndërsa diskutoi rëndësinë thelbësore të forcimit të parandalimit dhe mbrojtjes së Aleancës, admirali Cavo Dragone theksoi se, “ndërsa fokusohemi në qëndrueshmërinë në të gjitha nivelet e Aleancës, Forcat Rezervë mund të përmbushin role të rëndësishme specialistike në rritjen e qëndrueshmërisë sonë dhe të partnerëve tanë”. Më tej tha se “Forcat Rezervë luajnë një rol të rëndësishëm në të gjithë spektrin e strukturave mbrojtëse kombëtare dhe të NATO-s”.

Admirali Cavo Dragone theksoi shumë shembuj historikë që tregojnë se si rezervistët janë kritikë për të ndihmuar shoqërinë në kohë nevojash të mëdha. Kjo përfshin COVID-19 dhe zjarret më të fundit në Los Angeles. Lavdërimi i tij theksoi sesi rezervistët veprojnë si një kanal midis ushtrisë

dhe sektorit privat. Duke deklaruar se rezervistët mishërojnë rolin e dyfishtë të qytetarit dhe ushtarit, duke i bërë ata të pozicionuar në mënyrë unike për të kontribuar në një qasje të gjithë shoqërisë ndaj parandalimit dhe mbrojtjes.

Admirali Cavo Dragone përfundoi vërejtjet e tij, duke inkurajuar rezervistët që të ndajnë përvojën e tyre me njëri-tjetrin. “Kjo plenare është një platformë unike për të nxitur bashkëpunimin me njëri-tjetrin. Në një botë gjithnjë e më të ndarë, nuk ka armë më të fuqishme se uniteti ynë”, - tha ai. Takimi plenar i shumanshëm përfshinte informime, diskutime tematike dhe punë në sindikatë. Fokus i kryesor i takimit të këtij viti ishte politika e re e NATO-s për Rezervat, e cila u miratua në nëntor 2024. Politika e re synon të çimentojë promovimin e rezervave në kontribut në detyrat, operacionet, misionet dhe aktivitetet kryesore të NATO-s.

Për të ruajtur Forcat Rezervë të NATO-s, Aleanca bashkëpunon me NCR, CIOR, CIOMR dhe CISOR. Fokus i grupeve përfshin këshillimin e Komitetit Ushtarak si dhe trajnimin dhe edukimin e rezervistëve ndër-aleatë. Së bashku, këto entitete bashkëpunojnë për të harmonizuar programet dhe projektet e tyre përkatëse për të çuar më tej misionin e parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s.

KANUNI I LABËRISË, pasuri që vjen nga Iliria

Sipas studimeve, prof. dr. Ismet Elezi konstaton se kanuni i Labërisë e ka zanafillën nga ilirët e lashtë...

Gjatë rrjedhave të historisë, në të gjitha malësitë shqiptare ka vepruar një e drejtë doktrimore, pra një ligj popullor. Ato ishin një kompleks ligjesh të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë bashkësitë, pavarësisht nga pozita dhe pozicioni shoqëror. Këto ligje njiheshin me emrin kanun. Kanuni është një kushtetutë e pashkruar.

Sipas prof. dr. Ismet Elezit mendohet që kanuni i Labërisë e ka zanafillën nga ilirët e lashtë. Këtë tezë e mbrojnë shumë studiues të huaj. Ai zbatohej në 165 fshatra të Labërisë dhe sigurisht në qytete si Vlora, Saranda, Gjirokastra, Tepelena dhe Delvina.

Kanuni i Labërisë përbëhej nga sanksionimi i etikës dhe vlerave morale si dhe parimet themelore juridike si mbrojtja e nderit, burrërisë, fisnikërisë, besës, mikpritjes, bujarisë dhe barazisë së njerëzve.

Prof. dr. Elezi e vë theksin tek ngjashmëria që ka Kanuni i Labërisë me funksionimin e shoqërisë homerike që është kaq e njohur në veprat e Homerit dhe përkatësisht tek "Iliada" dhe "Odiseu". Ka shumë ngjashmëri dhe me funksionimin e shoqërisë post-homerike. Në këto përfundime kanë dalë të gjithë vizitorët e huaj që vizituan vendin tonë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjysmën e parë të shekullit XX.

Po në këtë përfundim ka dalë dhe studiuesi i famshëm japonez Kazuhiko Yamamoto. Në librat e tij ai thekson tezën se struktura homerike është e përbërë nga besa, nderi, miku, gjaku dhe hakmarrja. Pra studiuesi japonez gjen shumë të përbashkëta, duke mbështetur tezën e hershmërisë së popullit shqiptar. Një tezë shumë e rëndësishme që del në përfundimin se popullsia shqiptare ka një histori zhvillimi dhe qytetërimi po aq të lashtë sa ajo e grekëve.

Kanuni i Labërisë mbart në vetvete norma shumë të lashta dhe me karakter primitiv. Ai është studiuar me shumë kujdes, sepse përmban norma të së drejtës ilire, të rendit gjinor e farefisnor dhe më pas është pasuruar me norma të të gjitha fazave që ka kaluar historia shqiptare nëpër shekuj.

Zakonet popullore u kthyen në norma juridike të pashkruara

Në terma më të kuptueshëm ai përmbante fillimisht disa tabu, veprime që nuk duhet të kryheshin nga anëtarët e komunitetit, në asnjë rrethanë. Ai shpjegon normat e moralit, norma që tregonin se kush ishte e mira dhe e keqja, si duhet të stimuloheshin veprat e mira dhe si duhet të luftoheshin të këqijat. Me kalimin e kohës të gjitha këto u kthyen në zakone të shqiptarëve.

Vendi ynë ka qenë një territor i pushtuar nga shumë pushtues të huaj. Si është e mundur që shqiptarët nuk zbatonin ligjet e pushtuesve? Profesor Elezi e ka një përgjigje shkencore. Askush nga të huajt nuk arriti të impononte të drejtën e tij ligjore. Labët vazhdonin të qeveriseshin nga e drejta zakonore duke shpërfillur romakët, bizantët dhe turqit. E drejta zakonore asnjëherë nuk u asimilua nga të huajt.

Gojëdhënat popullore rrëfejnë se krijuesi i Kanunit të Labërisë ishte Papa Zhuli, që ka jetuar në shekullin XI. Ai ishte një prift i Zhulatit dhe ka jetuar në kohën kur Shqipëria ishte nën pushtimin bizantin.


Profesor Elezi ngul këmbë që e drejta zakonore është shumë më e vjetër dhe ndoshta Papa Zhuli vetëm mblodhi atë që ishte trashëgimi e lashtë nga ilirët. Dokumentet e para për Kanunin e Labërisë do të vinin në vitin 1492, kur Perandoria otomane do njihte Himarën si kryeqendrën e Labërisë. Udhëtarë të huaj të kësaj kohe si Lik, Liri, Hobhans dëshmojnë në veprat e tyre për një kod zakonor që ishte baza e qeverisjes së krahinës.

Në Kanunin e Labërisë, ajo që të bën përshtypje është martesja. Sipas këtij kanuni martesja ishte monogame dhe egzogame, duke i shpallur luftë çdo lloj martese tjetër.

Një vend të rëndësishëm në Kanunin e Labërisë zinin normat e zhvillimit ekonomik të krahinës si dhe ndarja e sinorëve dhe pasurisë.

Prona private, format e tjera të pronësisë, trashëgimia trajtohen gjerësisht. Gjithashtu flitet dhe për sanksionet ndaj keqbërësve, atyre që shkelnin besën, marrëdhëniet në familje etj.

Kanuni i Labërisë dhe Kanuni i Lekës e Kanuni i Skënderbeut, pavarësisht se kanë vepruar në kohë e hapësirë të ndryshme, se i pari i referohet nga gojëdhëna shek. XI, kurse të dytët shek. XV, se i pari ka vepruar në Jugperëndim të Shqipërisë dhe të dytët në Malësinë e Veriut, kanë shumë norma të ngjashme e të



njëllojta, kanë një nënshtrat të përbashkët, janë pjesë përbërëse të Kanunit mbarë popullor shqiptar, i cili mbijetoi e përballoi stuhitë e pushtimeve të huaja gjatë shekujve.

Këto ngjasime kanë në themel të tyre etikën, sistemin e vlerave të larta morale dhe parimet kryesore juridike të së drejtës zakonore të tij, lidhjet kulturore e shpirtërore të popullit shqiptar.

Gjithashtu ngjasime ka në organizimin e brendshëm shoqëror, para shtetëror, mbështetur në lidhjet farefisnore në vëllazëritë e mëdha e të vogla, në institucionin e pleqve e të kuvendeve të burrave, si organizma të vetëqeverisjes vendore, në rregullimin e marrëdhënieve të pronësisë, të trashëgimisë, të detyrimeve, e deri te rregullat e hetimit e të gjykimit të çështjeve. Analiza e hollësishme e ngjasimeve të këtyre kanuneve është bërë në një studim të veçantë nga autori (shih: Jeta Juridike N.2/2004).

Njëkohësisht, nga njohja me përmbajtjen e kanuneve, nuk mund të mos vihen në dukje edhe dallimet e veçoritë vendore, ashtu si në gjuhë dialektet, në kostumet, në këngët, vallet etj., të përcaktuara në analizë të fundit nga kushtet historike, politike, shoqërore dhe materiale të jetesës së popullsisë së njëres apo tjetres trevë.

Ndër këto dallime thelbësore vërehet zhvillimi i marrëdhënieve kapitaliste në prodhim në Labëri, në krahasim me zonat ku vepronte Kanuni i Lekës dhe Kanuni i Skënderbeut në Malësitë e Veriut. Nga përcaktimi në analizë të fundit i këtyre marrëdhënieve ekonomike u shfaqën edhe dallimet në strukturën klasore të shoqërisë në Labëri. Në disa fshatra, sidomos në Rrëzomë, u krijuan shtresa të reja të pasura - agallarët, u forcuan më tej çifligarët, u zgjeruan shtresat

e mesme të pronarëve të tokës e të bagëtive, u thellua varfëria e shtresave të ulëta, që përbënin shumicën, veçanërisht në Kurvelesh. Secila prej këtyre shtresave kishte një status të veçantë në Kanun, dhe barazia shoqërore e dikurshme e bashkësisë fisnore (gjinore) gradualisht në shek. XVIII-XX shkante duke u kufizuar, ndërsa barazia e gjakut 'gjak për gjak' u ruajt edhe në vitet pasardhës.

Si rrjedhojë e këtyre dallimeve ekonomike-shoqërore, Kanuni i Labërisë rregullonte marrëdhëniet juridike ndërmjet çifligarëve e çifçinjve, marrëdhënieve civile e kontraktore të pronarëve të tokës e bujqve, agallarëve pronarëve të kopeve të bagëtive e çobanëve që paraqesin dallim të dukshëm të Kanunit të Labërisë nga Kanuni i Lekës apo Kanuni i Skënderbeut në Veri të Shqipërisë.

Dallime jo të pakta vërehen edhe në rregullimin e marrëdhënieve familjare e martesore. Fiset dhe familjet e mëdha patriakale në Labëri, që nga gjysma e dytë e shekullit XVIII dhe fillimet e shek. XIX, ishin në procesin e shpërbërjes së plotë dhe ua linin vendin vëllazërive, familjeve të mesme e të vogla, të ndara nga trugu prindëror, me ekonomi më vete, të vogël apo të mesme. Tradita gojore dëshmon se familja labe, në shumicën e madhe, përbëhej si rregull nga 10-20 veta, maksimumi deri në 30 veta, ndryshe nga ajo në Zonat e Veriut, ku vepronte Kanuni i Lekës apo Kanuni i Skënderbeut, që arrinte deri në 100 veta.

Zakonet e vjetra patriarkale ishin skllavëruese për gruan. Ato nuk i njihnin asaj të drejta në krahasim me burrin, veçse i mbronin nderin e saj.

Kanuni mbetet vlerë e padiskutuar e entitetit shqiptar.



Ministria e Mbrojtjes hapi aplikimet për 1 (një) kandidat për të ndjekur: “Kursin fillestar të Oficerit të Forcës Detare”, i cili do të zhvillohet në periudhën 8 shtator 2025 – 14 gusht 2026, në Kolegjin Mbretëror të Forcave Detare në Dartmouth, në Britaninë e Madhe.

Kandidimi është i hapur për rekrutë, ushtarë dhe nënoficerë që kanë përfunduar studimet “bachelor”, brenda ose jashtë vendit.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 17 shkurt 2025.

Për më shumë informacion klikoni më poshtë:

<https://shorturl.at/a0JI6>